



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 13

Tiranë – E premte, 19 janar 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 106/2023, datë 21.12.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”... 2189
Dekret i Presidentit nr. 15, datë 18.1.2024	Për shpallje ligji..... 2191
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 17.1.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës – terminali i transportit publik tiranë (PPT) dhe lidhja me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA)”..... 2191
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 17.1.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Lidhja e Rrugës Transballkanike me Portin Detar”, Vlorë..... 2195
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 21, datë 17.1.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 150, datë 13.3.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve dhe të normave të trajtimit me uniformë të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”..... 2201
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 22, datë 17.1.2024	Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2024..... 2203
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 17.1.2024	Për miratimin e buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2024..... 2205
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 17.1.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 255, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e përbërjes strukturore e të shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit”..... 2205
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 17.1.2024	Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2024..... 2206

Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 19, datë 15.1.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 267, “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, i ndryshuar.....	2210
Vendim i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 3, datë 15.12.2023	Me objekt ankimi konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 117, datë 17.9.2001, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.....	2213



LIGJ
Nr. 106/2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 8891, DATË 2.5.2002,
“PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E KOMISIONEVE
HETIMORE TË KUVENDIT”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 81, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeteje,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 të ligjit bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 e nenit 2 të ligjit ndryshohet si më poshtë:

“1. “Komision hetimor” është komisioni i ngritur sipas pikës 2 të nenit 77 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe që vepron sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj.”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. “Çështje e veçantë” është ajo çështje që hetohet në aspektin e kontrollit dhe zbatimit të ligjeve, të njohjes dhe verifikimit në thellësi të një fenomeni, ngjarjeje apo veprimtarie dhe që nxit iniciativa për propozime, amendime apo miratime ligjesh, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative për shoqërinë dhe shtetin, si dhe nxjerrjen e përgjegjësiwe institucionale.”.

3. Pika 6 e nenit 2 ndryshohet si më poshtë:

“6. “Ekspert ligjor” është personi me njohuri të konsoliduara në fushën e hetimit, që zgjidhet dhe shkarkohet me një shumicë prej 2/3 të anëtarëve të komisionit.”.

Neni 2

Pika 1 e nenit 3 ndryshohet si më poshtë:

“1. Komisionet hetimore të Kuvendit krijohen për të hetuar çështje të veçanta sipas pikës 2 të nenit 77 të Kushtetutës. Komisionet hetimore janë mjet efektiv kontrolli që veprojnë vetëm brenda hapësirës kontrolluese të parlamentit e të lidhura në mënyrë funksionale me pushtetin e ligjvënësit.”.

Neni 3

Në nenin 4 të ligjit bëhen ndryshimet e mëposhtme:

“1. Komisionet hetimore të Kuvendit ngrihen dhe funksionojnë mbi bazën e parimeve kushtetuese dhe rregullave të përcaktuara në këtë ligj si më poshtë:

- a) parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve;
- b) parimi për një proces të rregullt ligjor;
- c) parimi i prezumimit të pafajësisë;
- d) parimi i paanshmërisë dhe i respektimit të jetës private të individit.”.

3. Në fund të pikës 2 hiqet shprehja “për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe”.

4. Pika 4 shfuqizohet.

5. Në pikën 5 dhe kudo në ligj pas fjalëve “Prokuror i Përgjithshëm” shtohen fjalët “/Drejtues i Prokurorisë së Posaçme”.

Neni 4

Në pikën 1 të nenit 5 fjalja e tretë riformulohet si më poshtë:

“Kuvendi është i detyruar të miratojë ngritjen e komisionit kur objekti i hetimit respekton parimet dhe standardet kushtetuese si më poshtë:

- a) çështja duhet të ketë të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera të Kuvendit;
- b) objekti i hetimit duhet të fokusohet në çështje ose në subjekte konkrete;
- c) duhet të ekzistojnë të dhëna ose indicie të mjaftueshme për ekzistencën e çështjes për të cilën kërkohet ngritja e komisionit hetimor.”.

Neni 5

Në nenin 7 të ligjit dhe kudo në ligj fjalët “Byroja e Kuvendit/Byronë e Kuvendit” zëvendësohen me



fjalët “Konferenca e Kryetarëve/Konferencën e Kryetarëve”.

Neni 6

1. Në pikën 1 të nenit 12 të ligjit shprehja “dhe/ose me autorizim të tij” zëvendësohet me shprehjen “dhe në mungesë ose pamundësi të tij”.

2. Në fund të pikës 2 të nenit 12 shtohet fjalia: “Drejtuksi i mbledhjes së komisionit zbaton rregullat për masat disiplinore të parashikuara në Rregullore dhe Kodin e Sjelljes së Deputetëve.”.

3. Pika 3 e nenit 12 riformulohet si më poshtë:

“3. Mbledhjet e komisionit si rregull janë të hapura. Komisioni hetimor me vendim të ndërmjetëm përjashton publikun nga mbledhjet e tij nëse:

a) duhet t’u referohen fakteve që kanë të bëjnë me jetën personale të dëshmitarëve ose të palëve të treta;

b) kur rrezikohet jeta, shëndeti dhe liria e dëshmitarit ose personit të lidhur me të;

c) kur bëhen referenca për një sekret tregtar, të klasifikuar si informacion “sekret”;

d) kur publiciteti mund të sjellë përhapjen e të dhënave që duhet të mbahen sekret në interes të shtetit.”.

4. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Kryetari i komisionit informon personat që marrin pjesë në mbledhjen e zhvilluar me dyer të mbyllura për detyrimin që kanë për të ruajtur konfidencial informacionin e mësuar në mbledhje.”.

Neni 7

1. Pika 4 e nenit 13 riformulohet si më poshtë:

“4. Vendimarrja e lidhur me provat realizohet me vendim të ndërmjetëm të shumicës së anëtarëve që kërkon kjo lloj vendimarrje.”

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Kërkesa për pyetjen e dëshmitarëve ose marrjen e provave të tjera, pasi ka filluar shqyrtimi, mund të ngrihet nga çdo anëtar komisioni dhe pranohet me vendim të ndërmjetëm të komisionit. Hetimi fillon me marrjen e provave të kërkuara nga grupi nismëtar i komisionit dhe vazhdon me marrjen e provave që kërkojnë nga grupimi tjetër jonismëtar.”.

Neni 8

1. Pikat 1 dhe 2 të nenit 15 të ligjit riformulohen si më poshtë:

“1. Pas njohjes me objektin e çështjes që do të hetohet, komisioni nëpërmjet ekspertit ligjor/ekspertëve ligjorë, të zgjedhur nga 2/3 e anëtarëve të komisionit, mbledh të dhëna për çështjen. Të dhënat mund të jenë informacione zyrtare dhe jozyrtare, por që njihen publikisht.

2. Eksperti ligjor/ekspertët ligjorë ia raportojnë gjetjet e tyre me shkrim dhe verbalisht komisionit si dhe propozojnë planin e hetimeve. Eksperti ligjor/ekspertët ligjorë ndalohen të bëjnë deklarata publike mbi gjetjet.”.

2. Në pikën 3 pas shprehjes “për çështjen” shtohen fjalët “nga eksperti ligjor/ekspertët ligjorë” dhe pas fjalëve “planin e hetimeve” shtohen fjalët “sipas propozimeve të ekspertëve”.

Neni 9

1. Pas pikës 1 të nenit 16 shtohen pika 1/1 dhe pika 1/2 me këtë përmbajtje:

“1/1. Dëshmitari nuk duhet të dëshmojë për çka flitet në publik dhe as të shprehë vlerësime personale, me përjashtim të rasteve kur ato nuk mund të ndahen nga dëshmia për faktet.

1/2. Për pyetjen si dëshmitarë të personave që janë thirrur ose do të thirren nga organi i prokurorisë/gjykatës për procesin penal të lidhur eventualisht me çështjen objekt hetimi, komisioni merr leje paraprakisht nga prokuroria ose gjykata ku ndodhen aktet për objektin dhe kufijtë e dëshmisë.”.

2. Pas pikës 2 të nenit 16 shtohen pika 2/1 deri në pikën 2/5 me këtë përmbajtje:

“2/1. Pyetja e dëshmitarëve si rregull bëhet individualisht dhe pa praninë e dëshmitarëve të tjerë që do të pyeten më vonë.

2/2. Çdo dëshmitar, përpara se të pyetet, informohet për çështjen për të cilën i kërkohet të dëshmojë, për të drejtat e tij ligjore dhe për pasojat ligjore të mosparaqitjes.

2/3. Dëshmitarët kanë të drejtë të kërkojnë ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tyre për seancën dëgjimore. Çdo dëshmitar i jepet mundësia e një deklarate paraprake të kontekstualizuar lidhur me objektin e pyetjes.

2/4. Dëshmitarët mund të refuzojnë të japin informacion në përgjigje të pyetjeve që u drejtohen,



nëse përgjigjja e këtyre pyetjeve do t'i ekspozonte ata ose personat e lidhur me ta ndaj rrezikut të hetimit sipas një procesi të rregullt ligjor.

2/5. Pyetja e çdo dëshmitari respekton për aq sa është e mundur rregullat e parashikuara në nenin 95 të Rregullores së Kuvendit.”.

Neni 10

Pika 2 e nenit 24 të ligjit shfuqizohet.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 21.12.2023.

Shpallur me dekreten nr. 15, datë 18.1.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 15, datë 18.1.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 106/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002, Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Bajram Begaj

VENDIM

Nr. 19, datë 17.1.2024

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
“REHABILITIMI I LINJËS
HEKURUDHORE DURRËS –
TERMINALI I TRANSPORTIT PUBLIK
TIRANË (PPT) DHE LIDHJA ME
AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË
TIRANËS (TIA)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës – terminali i transportit publik Tiranë (PPT) dhe lidhja me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA)”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 104 085 941.87 (njëqind e katër milionë e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet e një pikë tetëdhjetë e shtatë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 104 085 941.87 (njëqind e katër milionë e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet e një pikë tetëdhjetë e shtatë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sh.a.



6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sh.a.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë dhe Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë që shpronësohen sipas këtij vendimi në favor të shtetit në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së

Financave dhe Ekonomisë për shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” sh.a.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë që shpronësohen sipas këtij vendimi në favor të shtetit në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” sh.a.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sh.a., drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamzë Vorë dhe Tiranë Rurale 2, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku



LISTA E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME PRONË PRIVATE E TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTT, PËR INTERES PUBLIK, “REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE DURRËS – TERMINALI I TRANSPORTIT PUBLIK TIRANË (PTT) DHE LIDHJA ME AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS (TIA)”

NR.	P R O N A R I			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				S H Ë N I M E (Kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Trrall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	VLERA TOTALE (lek)	
	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	Z
1	SHOQËRIA ALFA SHA			BËRXULL	1167	544/28	ARË	1200	1200			11	177	49.0	2114.82	103,626.18	103,626.18	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
2	ADRIATIK	PETRIT	ÇEJKU	BËRXULL	1167	470/80	ARË	2400	2400			13	148	1890.0	2114.82	3,997,009.80	3,997,009.80	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja Bllokuar në favor të Banka Credins për shumën 3000000 lekë K. Hip. 4873/1762
3	SAFIE MATRAXHI, BILBIL, MATRAXHI, FTORË MEMA MATRAXHI, ZEJNEL MATRAXHI, BASHKIM MATRAXHI, BESIM MATRAXHI, MANUSHAQE MATRAXHI			BËRXULL	1167	470/71	ARË	6400	6400			12	89	2510.0	2114.82	5,308,198.20	5,308,198.20	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
4	GAZMEND HALIT MJOJLI, GLOTILDA HAMIT XHAFA			BËRXULL	1167	470/74	ARË	1400	1400			13	26	1201.0	2114.82	2,539,898.82	2,539,898.82	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
5	FORCIM	SHEFKI	ÇEJKU	BËRXULL	1167	470/81	ARË	1200	1200			13	169	879.0	2114.82	1,858,926.78	1,858,926.78	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja Pas. rivlerësohet me shumën 6000000, datë 20.2.2020, ap. nr. 1762, rivlerësim ap. 1762, datë 13.2.2020
6	DILAVER	SHEFKI	ÇEJKU	BËRXULL	1167	470/82	ARË	1200	1200			13	170	210.0	2114.82	444,112.20	444,112.20	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja Rivlerësohet pas. me 6000000 lekë rap. vlerësimi ing. Tomorr Kotorrja. Aplikim nr. 1807, datë 14.2.2020
7	MARIE	MUSTAFA	XHIXHO	BËRXULL	1167	470/64	ARË	1500	1500			12	9	1038.0	2114.82	2,195,183.16	2,195,183.16	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
8	XHEMILE HAKA, ALTIN HAKA, AGRON HAKA			BËRXULL	1167	480/24	ARË	3000	3000			10	167	1145.0	2114.82	2,421,468.90	2,421,468.90	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
9	SAMI	ALI	HAKA	BËRXULL	1167	480/63	ARË	22506	22506			14	71	1389.0	2114.82	2,937,484.98	2,937,484.98	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja Mbi këtë pas. qëndron pasuria nr. 480/63/nd. vol. 15, f. 162 ZK 1167. Ndërtesa nuk preket nga shpronësimi.
10	JAKUP	ABDULLA	HAKA	BËRXULL	1167	310/8	ARË	4000	4000			4	166	323.0	2114.82	683,086.86	683,086.86	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
11	XHEMAILE	HARIF	HAKA	BËRXULL	1167	310/9	ARË	4000	4000			4	167	1270.0	2114.82	2,685,821.40	2,685,821.40	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
12	IDRIZ	ABDULLAH	HAKA	BËRXULL	1167	310/12	ARË	4000	4000			4	170	1430.0	2114.82	3,024,192.60	3,024,192.60	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
13	BLERIM	SHERIF	HAKA	BËRXULL	1167	310/18	ARË	2000	2000			13	112	246.0	2114.82	520,245.72	520,245.72	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
14	LATIF		HAKA	BËRXULL	1167	203/3	ARË	8000	55			3	59	346.0	2114.82	731,727.72	731,727.72	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
15	IBRAHIM	SHABAN	HAKA	BËRXULL	1167	203/4	ARË	5300	5300			3	60	2688.0	2114.82	5,684,636.16	5,684,636.16	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
16	BESNIK	DAUT	HAKA	BËRXULL	1167	203/5	ARË	5400	5400			3	61	693.0	2114.82	1,465,570.26	1,465,570.26	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
17	LIJMAN		REZI	BËRXULL	1167	134/10	ARË	7900	7900			12	153	755.0	2114.82	1,596,689.10	1,596,689.10	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
18	AGIM	LIJMAN	REZI	BËRXULL	1167	134/12	ARË	5100	5100			12	161	605.0	2114.82	1,279,466.10	1,279,466.10	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
19	QAZIM		REZI	BËRXULL	1167	134/5	ARË	6900	6900			2	245	338.0	2114.82	714,809.16	714,809.16	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
20	MUHARREM	HASAN	REZI	BËRXULL	1167	134/6	ARË	3700	3700			2	246	208.0	2114.82	439,882.56	439,882.56	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
21	ALI	HASAN	REZI	BËRXULL	1167	134/8	ARË	3800	3800			2	248	29.0	2114.82	61,329.78	61,329.78	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
22	ROLAND	ENVER	HYSA	BËRXULL	1167	133/16	ARË	3000	3000			9	130	45.0	2114.82	95,166.90	95,166.90	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
23	BUKURIE		ALLIETA	BËRXULL	1167	133/14	ARË	1500	1500			9	128	71.0	2114.82	150,152.22	150,152.22	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja Pas. rivlerësohet me shumën 672000



																		lekë, i vlefshëm deri në transaksionin e radhës d. trashëgimisë ap. nr. 19694, datë 19.10.2020
24	DAUT	HYSEN	ALLMETA	BËRXULL	1167	133/27	ARË	5000	5000			12	214	535.9	2114.82	1,133,332.04	1,133,332.04	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja Kërkesë nr. 7885, datë 29/09.2006, vlera e pas. është në shumën 2240000 lekë
25	PETRIT	RAMAZAN	ALLMETA	BËRXULL	1167	133/26	ARË	2500	2500			12	213	354.0	2114.82	748,646.28	748,646.28	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
26	ROLAND	ENVER	HYSA	BËRXULL	1167	133/10	ARË	5100	5100			2	237	1059.0	2114.82	2,239,594.38	2,239,594.38	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
27	ROLAND	ENVER	HYSA	BËRXULL	1167	133/8	ARË	4500	4500			2	235	807.0	2114.82	1,706,659.74	1,706,659.74	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
28	ROLAND	ENVER	HYSA	BËRXULL	1167	133/7	ARË	5100	5100			2	234	977.0	2114.82	2,066,179.14	2,066,179.14	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
29	HANKE RAMAZAN HAKA, FLORETA HALIM MICI, ILIR HALIM HAKA, EDMOND HALIM HAKA			BËRXULL	1167	133/33	ARË	3100	3100			15	72	368.0	2114.82	778,253.76	778,253.76	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
30	ROLAND	ENVER	HYSA	BËRXULL	1167	133/28	ARË	1820	1820			12	226	346.0	2114.82	731,727.72	731,727.72	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
31	AHMET	ABDULLA	HOXHA	BËRXULL	1167	133/24	ARË	4500	4500			12	165	913.0	2114.82	1,930,830.66	1,930,830.66	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
32	AGIM	ABDULLA	HOXHA	BËRXULL	1167	133/3	ARË	4000	4000			2	230	671.0	2114.82	1,419,044.22	1,419,044.22	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
33	SHERIF	ABDULLA	HOXHA	BËRXULL	1167	133/5	ARË	4500	4500			2	232	636.0	2114.82	1,345,025.52	1,345,025.52	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
34	AHMET	ABDULLA	HOXHA	BËRXULL	1167	133/23	ARË	2000	2000			12	164	443.0	2114.82	936,865.26	936,865.26	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
35	HASIM	ILMI	SPAHIU	BËRXULL	1167	133/21	ARË	6480	6480			10	192	1479.0	2114.82	3,127,818.78	3,127,818.78	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
36	HAMDI	REXHEP	NDREU	BËRXULL	1167	29/20	ARË	2000	2000			13	24	948.0	2114.82	2,004,849.36	2,004,849.36	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
37	MAZLLAM	MEHMET	LAMA	QEREKË	3096	231/9	ARË	10762	10762			4	52	2210.0	5287.05	11,684,380.50	11,684,380.50	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja Rivlerësohet pas. me vlerën 3185552 lekë
38	MEHMET	MAZLLAM	LAMA	QEREKË	3096	231/8	ARË	2880	2880			4	117	605.0	5287.05	3,198,665.25	3,198,665.25	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja Rivlerësohet pas. me vlerën 852480 lekë
39	GANI	MEHMET	LAMA	QEREKË	3096	231/7	ARË	3040	3040			4	43	498.0	5287.05	2,632,950.90	2,632,950.90	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
40	ZENEL	MEHMET	LAMA	QEREKË	3096	231/6	ARË	13780	13700			4	42	1992.0	5287.05	10,531,803.60	10,531,803.60	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
41	METUSH	ZENEL	LAMA	QEREKË	3096	231/5	ARË	5562	5562			4	40	819.0	5287.05	4,330,093.95	4,330,093.95	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
42	HAZUR	BAFTJAR	LAMA	QEREKË	3096	231/4	ARË	20952	20952			4	62	1853.0	5287.05	9,796,903.65	9,796,903.65	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
43	FERIDE TEFIK JATA, XHEVAHIR SAMI JATA, PERPARIM SAMI JATA, LULJETA SAMI GJANA JATA, KUJTIM SAMI JATA, ILIR SAMI JATA			QEREKË	3096	231/3	ARË	19909	19909			11	190	152.0	5287.05	803,631.60	803,631.60	KONFIRMUAR NGA ASHK-ja
VLERA TOTALE																104,085,941.87	104,085,941.87	

**VENDIM****Nr. 20, datë 17.1.2024**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “LIDHJA E
RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME
PORTIN DETAR”, VLORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Lidhja e Rrugës Transballkanike me portin detar”, Vlorë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, “ndërtesë”, “njësi” dhe “apartament”, me një vlerë të përgjithshme prej 182 020 370.86 (njëqind e tetëdhjetë e dy milionë e njëzet mijë e treqind e shtatëdhjetë pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 182 020 370.86 (njëqind e tetëdhjetë e dy milionë e njëzet mijë e treqind e shtatëdhjetë pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekësh përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Vlorë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Vlorë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Vlorë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Vlorë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTTT “LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME PORTIN DETAR”, VLORË

Nr.	Pronari	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Volum	Faqe	Truall m ²	Ndërtesë m ²	Adresa	Sipërfaqe truallit për shpronësim	Çmimi i truallit lek/m ²	Vlera e truallit lek	Sipërfaqe ndërtimi për shpronësim	Çmimi i ndërtimit lek/m ²	Vlera e ndërtimit, lek	Vlera e truallit dhe ndërtesë	Shënime
1	Viron Xhavora	8604	32/39-ND	Ndërtesë	28	225		105	Vlorë				105	52,296.00	5,491,080.00	5,491,080.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Sipas origjinës objekti është i llojit banim. Truallit që ndodhet nën këtë pasuri është në pikën 2 të tabelës.
2	Viron Xhavora	8604	32/39-T	Truall	28	224	140		Vlorë	92	6,899.00	634,708.00			-	634,708.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Kufizim. Plotësim dosjeje. Prona është me hartë e vjetër.
3	Sose Lato Barjami	8604	32/243	Truall	20	119	54		Vlorë	54	6,899.00	372,546.00			-	372,546.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	Sose Lato Barjamaj	8604	32/306+1-ND1/1	Ndërtesë	20	124		54	Vlorë		6,899.00	-	54		-	1,731,506.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh, pasi objekti, sipas origjinës së pronës është i llojit bar-bute. Truallit që ndodhet nën këtë pasuri është në pikën 3 të tabelës.
5	Shoqëria "Orikum" sh.p.k., Edison Sali	8604	32/306+1-ND1/2	Ndërtesë	20	125		73	Vlorë		6,899.00	-	73		-	2,340,740.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh, pasi objekti, sipas origjinës së pronës është i llojit njësi. Truallit që ndodhet nën këtë pasuri është në pikën 7 të tabelës.
6	Salvatore Tafuro	8604	32/306+1-ND2	Ndërtesë	20	123		127			6,899.00	-	127		-	4,072,246.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Truallit që ndodhet nën këtë pasuri është në pikën 7 të tabelës.
7	Shoqëria Orikum Edison Sali	8604	32/306	Truall	27	63	1304		Vlorë	526	6,899.00	3,628,874.00			-	3,628,874.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Pasuria 32/306-ND, vol. 27, faqe 61, është mbi pasurinë 32/306, vol. 27, faqe 63. Siç edhe kemi konfirmuar nëpërmjet korrespondencës me email, datë 12.10.2023, pasuria nr. 32/306-ND, vol. 27, faqe 61, i llojit objekt, nuk preket nga shpronësimi.
8	Bardhyl Sali	8604	32/424	Truall	39	62	1660		Vlorë	1,660	6,899.00	11,452,340.00			-	11,452,340.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
9	Bardhyl Sali	8604	32/423	Truall	39	61	1574		Vlorë	127	6,899.00	876,173.00			-	876,173.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
10	Bardhyl Sali	8604	32/307-ND1	NJËSI	39	47		710	Vlorë		6,899.00	-	194		-	3,070,079.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Pasuria 32/307-nd 1, vol. 39, faqe 47, ngrihet mbi pasurinë 32/306 vol., 27 faqe 63. Nga kjo pasuri do të priset 194 m ² ndërtesë nga 710 m ² . Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh, pasi objekti, sipas origjinës së pronës është i llojit njësi. Situacioni total është në shumën 17 439 314 lekë dhe është llogaritur për 1102 m ² . Duke kalkuluar sipas sipërfaqeve të secilës pronë rezultojnë që pasuria me sipërfaqe 908 m ² të jetë llogaritur në shumën 14369235 lekë dhe pasuria me sip. 194 m ² të jetë llogaritur në shumën 3070079 lekë. Truallit që ndodhet nën këtë pasuri është në pikën 9 të tabelës.
11	Bardhyl Sali	8604	32/307-ND2	NJËSI	39	48		908	Vlorë		6,899.00	-	908		-	14,369,235.00	Konfirmuar nga ASHK-ja



																Pasuria 32/307-nd2, Vol.39 faqe 48, ngrihet mbi pasurinë 32/306, vol. 27, faqe 63. Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh, pasi objekti, sipas origjinës së pronës është i llojit njësi. Situacioni total është në shumën 17 439 314 lekë dhe është llogaritur për 1102 m². Duke kalkuluar sipas sipërfaqeve të secilës pronë rezultojnë që pasuria me sipërfaqe 908 m² të jetë llogaritur në shumën 14369235 lekë dhe pasuria me sip. 194 m² të jetë llogaritur në shumën 3070079 lekë. Trualli që ndodhet nën këtë pasuri është në pikën 8 të tabelës.
12	Rahmi Isufi	8604	32/314	Truall	17	230	200		Vlorë	160	6,899.00	1,100,390.50		-	1,100,390.50	Konfirmuar nga ASHK-ja Mbi këtë pasuri ndodhet pasuria nr. 32/15-ND (sipas shkresës nr. 8007/1 prot., datë 7.8.2023 të Bashkisë Vlorë, sqarohet se pasuria 32/15-ND është e llojit ndërtesë 4-katëshe: kati përderes njësi dhe 3 katet e sipërme apartamente. Kjo ndërtesë ndodhet brenda gjurmës së rrugës dhe prishet e gjitha pasqyruar kjo në pikat 13,14,15,16 të tabelës).
13	Rami Isufaj	8604	32/15-N1	Njësi	48	70	200		Vlorë		6,899.00	-	200	-	13,003,843.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Pikë karburanti sipas lejes së ndërtimit me vendim nr. 8/25, datë 16.6.1998, të KRRT-së Vlorë. Hipotekohet në favor të Societe General Albania. Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh, pasi objekti, sipas origjinës së pronës është i llojit njësi dhe pikë karburanti.
14	Rami Isufaj	8604	32/15+1-1	Apartament	48	71		216.4	Vlorë		6,899.00	-	216.4	52,296.00	11,316,854.40	Konfirmuar nga ASHK-ja Hipotekohet në favor të Societe General Albania.
15	Rami Isufaj	8604	32/15+1-2	Apartament	48	72		216.4	Vlorë		6,899.00	-	216.4	52,296.00	11,316,854.40	Konfirmuar nga ASHK-ja Hipotekohet në favor të Societe General Albania.
16	Rami Isufaj	8604	32/15+1-3	Apartament	48	73		216.4	Vlorë		6,899.00	-	216.4	52,296.00	11,316,854.40	Konfirmuar nga ASHK-ja Hipotekohet në favor të Societe General Albania.
17	Latif Reshat Totaj dhe Nadire Yzeir Totaj	8604	32/589	Truall	67	239	437		Vlorë	95	6,899.00	655,405.00		-	655,405.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Bashkim pasurie pas vendimit për miratimin e kërkesës për kalimin në pronësi të oborrit në përdorim nr. 280, datë 19.11.2021 dhe objektit 57 m² të regjistruar me nr. pasurie 32/16-ND, vol. 59, faqe 149.
18	Latif Reshat Totaj	8604	32/16-ND	Ndërtesë	59	149		57	Vlorë			-	57	52,296.00	2,980,872.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Vlorë Sipas origjinës së pronës së konfirmuar nga ASHK-ja dhe vëzhgimit në terren objekti është banesë. Kjo pasuri ngrihet mbi pasurinë 32/16-T, vol. 59, faqe 148. Mungon marrëdhënia me truallin. Në lidhje me truallin pasuria 32/16-T, vol. 59 faqe 148, ju sqarohet se: trualli preket nga vija e shpronësimit të projektit, por gjendet juridike nga ASHK, figuron pronar i



																	pavërtetuar, ndaj nuk është vendosur në tabelë.
19	BP Muhameti	8604	32/17-T	Truall	21	166	345		Vlorë	60	6,899.00	413,940.00		-	413,940.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Mbi këtë pasuri ngrihet pasuria 32/17-ND dhe 32/352. Pasuria nr. 32/352 nuk preket nga vija e shpronësimit. Në bazë të shkresës nr. 10494/L, prot., datë 23.12.2023, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Vlorë, "Sipërfaqja e parcelës ndërtimore e pasurisë me nr. 32/17, vol. 21, faqe 166, ZK 8604, është në pronësi të Teki Shaban Muhameti, Ferik Shaban Muhameti, Merfa Shaban Muhameti, Meti Shaban Muhameti dhe Sanije Shaban Muhameti".	
20	Llambi Todi Mino	8604	32/17-ND	Ndërtesë	21	165		68	Vlorë		6,899.00	-	68	52,296.00	3,556,128.00	3,556,128.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Sipas origjinës së pronës të konfirmuar nga ASHK-ja, objekti është banesë. Pasuria 32/17-ND, vol. 21, faqe 65 ngrihet mbi pasurinë 32/17-T, vol. 21, faqe 166. Mungon marrëdhënia me truallin (sipas shkresës nr. 8007/1 prot., datë 7.8.2023 të Bashkisë Vlorë, sqarohet se pasuria 32/17 - ND në pronësi të Llambi Mino, e cila ndodhet mbi truallin me nr. pasurie 32/17-T, pika 19 e tabelës, ndodhet brenda vijës së shpronësimit dhe prishet nga realizimi i projektit).
21	Agim,Fatmir dhe Petrit Mustafaraj	8604	32/20	Truall	20	184	290	70	Vlorë	126	6,899.00	865,824.50	13	52,296.00	679,848.00	1,545,672.50	Konfirmuar nga ASHK-ja Sipas origjinës së pronës së konfirmuar nga ASHK-ja dhe vëzhgimit në terren, objekti është banesë. Ndallim, plotësim dosje, deklarata kufitare, origjina vendim gjykate. Ka mbivendosje me pasuritë 32/17, 32/18 dhe 32/19. Subjekti ka depozituar deklarate noteriale për dakordësi për prerje objekti deri te vija e shpronësimit së bashku me aktin e qëndrueshmërisë, ndaj llogaritjet janë bërë për 13 m² që pret objektin, vija e shpronësimit.
22	Ollga,Stefan dhe Jani Papajani, Pavlina Janka Violeta Muka	8604	32/22	Truall	23	221	672	132	Vlorë	135	6,899.00	927,915.50	132	52,296.00	6,903,072.00	7,830,987.50	Konfirmuar nga ASHK-ja Kufizim veprimesh deri në plotësimin e deklaratës së kufitareve. Pasuria figuron në regjistër, por nuk është lëshuar certifikatë.
23	Xhemil, Sezai, Vladimir, Shqiponja, Fadil, Verxhina,Avdul, Myfit dhe Abibe Musa	8604	32/34+1-1	Apartament	18	84	66	66	Vlorë	66	6,899.00	455,334.00	66	52,296.00	3,451,536.00	3,906,870.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Sipas formularit nr. 2 është privatizuar edhe 66 m² truall.
24	Verë, Maregjen, Martin, Anxhela Sulejmani	8604	32/34+1-2	Apartament	63	178	49.9	41.5	Vlorë	49.9	6,899.00	344,260.10	41.5	52,296.00	2,170,284.00	2,514,544.10	Konfirmuar nga ASHK-ja Sipas formularit nr. 2 është privatizuar edhe 49.9 m² truall.
25	Sezai Musa	8604	32/533	Apartament	50	194	60	37	Vlorë	60	6,899.00	413,940.00	37	52,296.00	1,934,952.00	2,348,892.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Sipas formularit nr. 2 është privatizuar edhe 60 m² truall. Vendim nga Bashkia Vlorë nr. 39, datë 14.12.2015, për kalimin në pronësi të pas. pal. të ndërtuara deri me 10.8.1991 dhe truallit funksional të saj.



26	Kujtim Mahmutaj, Vitori Mahmutaj	8604	32/134+1-1	Apartament	18	89		58	Vlorë			-	58	52,296.00	3,033,168.00	3,033,168.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Në kartelën e konfirmuar nga ASHK nuk ka truall të privatizuar.
27	Arjan Çuni	8604	32/134+1-2	Apartament	18	90		39	Vlorë			-	39	52,296.00	2,039,544.00	2,039,544.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Në kartelën e konfirmuar nga ASHK nuk ka truall të privatizuar.
28	Armida, Esmeralda, Lefter dhe Thomaidha Bifsha	8604	32/134+1-9	Apartament	29	51	53.12	33.72	Vlorë	53	6,899.00	366,474.88	33.72	52,296.00	1,763,421.12	2,129,896.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Në kartelën e konfirmuar nga ASHK-ja ka 53 m ² truall të privatizuar.
29	Shpresa, Lonard, Alfred, Elisabeta Xhako dhe Gentiana Rapo	8604	32/134+1-10	Apartament	22	189		50	Vlorë			-	50	52,296.00	2,614,800.00	2,614,800.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Në kartelën e konfirmuar nga ASHK-ja nuk ka truall të privatizuar.
30	Gezim Lako	8604	32/33+1-2	Apartament	18	79		38	Vlorë			-	38	52,296.00	1,987,248.00	1,987,248.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Në kartelën e konfirmuar nga ASHK-ja nuk ka truall të privatizuar.
31	Pellumb Aliu	8604	32/33+1-3	Apartament	18	80		38	Vlorë			-	38	52,296.00	1,987,248.00	1,987,248.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Në kartelën e konfirmuar nga ASHK-ja nuk ka truall të privatizuar.
32	Sokol Velaj	8604	32/33+1-4	Apartament	18	81		44	Vlorë			-	44	52,296.00	2,301,024.00	2,301,024.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Në kartelën e konfirmuar nga ASHK-ja nuk ka truall të privatizuar.
33	Hiqmet Ibrahim, Natasha Papa	8604	32/33+1-5	Apartament	18	82		48	Vlorë			-	48	52,296.00	2,510,208.00	2,510,208.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Në kartelën e konfirmuar nga ASHK-ja nuk ka truall të privatizuar.
34	Odise Anagnosti	8604	32/546	Truall	53	54	143.3		Vlorë	23	6,899.00	158,677.00			-	158,677.00	Konfirmuar nga ASHK-ja.
35	Odise Anagnosti	8604	32/547-N1	Njësi	54	162		94	Vlorë			-	94		-	1,950,367.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Vlera e ndërtësës është llogaritur me situacion punimësh, pasi objekti, sipas origjinës së pronës është i llojit njësi. Truallin nën këtë pasuri është në pikën 34 të tabelës.
36	Odise Anagnosti	8604	32/547+1-1	Apartament	54	164		100	Vlorë			-	100	52,296.00	5,229,600.00	5,229,600.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Truallin nën këtë pasuri është në pikën 34 të tabelës.
37	Lavdie, Artan, Indit, Florentino Habibaj	8604	32/154-ND	Ndërtesë	22	134		68	Vlorë			-	68	52,296.00	3,556,128.00	3,556,128.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Sipas origjinës së pronës së konfirmuar nga ASHK-ja dhe vëzhgimit në terren objekti është banesë. Pasuria 32/154-ND është mbi pasurinë 32/154, vol., 22 faqe 135 (sipas shkrësës nr. 8007/1 prot., datë 7.8.2023 të Bashkisë Vlorë, sqarohet se pasuria 32/154 -ND në pronësi të Lavdie, Artan, Indit, Florentino Habibaj, ndodhet brenda vijës së shpronësimit dhe priset nga realizimi i projektit). Truallin me nr. pasurie 32/154, preket nga vija e shpronësimit, por nuk është vendosur në tabelë, pasi është pronar i pavërtetuar.
38	Dashamir Bilal Skënderaj, Ervis Dashamir Skënderaj dhe Lorenc Dashamir Skënderaj	8604	32/456	Truall	41	20	161.9		Vlorë	38	6,899.00	258,712.50	0	52,296.00	-	258,712.50	Konfirmuar nga ASHK-ja.
39	Feto Haderaj, Arben Haderaj, Sokol Haderaj dhe Mirela Haderaj	8604	32/236	Truall	21	103	568	123	Vlorë	149	6,899.00	1,027,951.00	123	52,296.00	6,432,408.00	7,460,359.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Ka kontratë sipërmarrjeje për ndërtim me nr. 2963 rep., nr. 976 kol., datë 7.10.2021.
40	Arben Qemal Dangaj, Fatbardha Isuf Dangaj	8604	32/257/1	Truall	64	157	250	88	Vlorë	29	6,899.00	200,071.00		52,296.00	-	200,071.00	Konfirmuar nga ASHK-ja.
41	Edmond Zabiti Gjonaj	8604	32/256-ND	Ndërtesë	21	79		50	Vlorë		6,899.00	-	50	52,296.00	2,614,800.00	2,614,800.00	Konfirmuar nga ASHK-ja.



																	Ngrihet mbi pasurinë nr. 32/256 (Sipas shkresës nr. 8007/1 prot., datë 7.8.2023 të Bashkisë Vlorë, sqarohet se pasuria 32/256-ND në pronësi të Edmond Gjonaj, e cila ndodhet mbi truallin me nr. pasurie 32/256, ndodhet brenda vijës së shpronësimit dhe priset nga realizimi i projektit. Pasuria nr. 32/256, truallin nën ndërtesë përfshihet në shpronësim në numrin rendor 42, në tabelë.
42	Edmond, Roland Gjonaj	8604	32/256	Truall	21	80	270		Vlorë	228	6,899.00	1,572,972.00		52,296.00	-	1,572,972.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
43	Jaho Avdulla Dano	8604	32/208-ND	Ndërtesë	21	121		20	Vlorë		6,899.00	-	20	52,296.00	1,045,920.00	1,045,920.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Ngrihet mbi pasurinë nr. 32/208. Kufizim veprimesh. Sqarohet se truallin me nr. pasurie 32/208, preket nga vija e shpronësimit, por nuk është vendosur në tabelë, pasi gjendja juridike e truallit me nr. pasurie 32/208, konfirmuar nga ASHK-ja është pronar i pavërtetuar.
44	Dhimitra Zotaj, Monika Petromilo, Balkeze Gjiriti, Arta Shehu, Gezime Gjiriti, Luljeta Zuna, Merita Gjiriti, Kujtim Gjiriti, Naile Zoloshnja, Nexhmije Osmani, Avdul Skenderaj, Qanie Asllani, Luan Hasanbelliu, Vangjeli Skenderaj, Denisa Rakipaj	8604	32/392	Truall	31	177	1000		Vlorë	659	6,899.00	4,546,441.00		-		4,546,441.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Mbi këtë pasuri ndodhen 2 ndërtesa. Revokuar prokura e Dhimitra Zotaj për Maksim Gjikutaj. Kontratë sipërmarrje në favor të D.H. Konstruksion. Kufizim. Vendim gjykatë. Sigurim padie nr. 3478, datë 13.12.2010. Sipas vendimit të Gjykatës, masa e sigurimit s'ka lidhje me vijimin e procedurave për shpronësim.
45	Gani Ismaili, Djana Naço, Esli Hajderi	8604	32/250	Truall	18	146	1870		Vlorë	388	6,899.00	2,676,812.00		-		2,676,812.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
46	Joni Begaj	8604	32/316-nd	Apartament	27	112		74.5	Vlorë		6,899.00	-	74.5	52,296.00	3,896,052.00	3,896,052.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Pasuria 32/316-ND, vol. 27, faqe 112, ngrihet mbi pasurinë nr. 32/316, vol. 27, faqe 131. Kufizim veprimesh deri në plotësim dokumentacioni. Sqarohet se truallin me nr. pasurie 32/316, preket nga vija e shpronësimit, por nuk është vendosur në tabelë, pasi gjendja juridike e truallit me nr. pasurie 32/316, Konfirmuar nga ASHK-ja është pronar i pavërtetuar.
47	Robert Begaj, Mimoza Begaj	8604	32/318	Apartament	27	200		35.06	Vlorë		6,899.00	-	35.06	52,296.00	1,833,497.76	1,833,497.76	Konfirmuar nga ASHK-ja Kryer rrvlerësimi i pasurisë 2166708 lekë. Kufizim veprimesh deri në plotësim dokumentacioni. Pasuria është e regjistruar, por nuk është lëshuar certifikatë, deri në plotësimin e dokumentacionit.
48	Rexhep Gani Çota	8604	32/557	Truall + ndërtesë	56	221	143.2	32.4	Vlorë	131	6,899.00	901,009.40	32.4	52,296.00	1,694,390.40	2,595,399.80	Konfirmuar nga ASHK-ja Mbi këtë pasuri ngrihet pasuria 32/23-ND1.
49	Rexhep Gani Çota	8604	32/23-ND1	Ndërtesë	52	86		10.5	Vlorë		6,899.00	-	10.5	52,296.00	549,108.00	549,108.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Kjo pasuri ngrihet mbi pasurinë 32/557.
50	Bedri Adem Çota	8604	32/556	Truall dhe ndërtesë	56	220	137.4	24.6	Vlorë	17	6,899.00	117,283.00	25	52,296.00	1,307,400.00	1,424,683.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
Vlera totale e shpronësimit																182,020,370.86	

**VENDIM**
Nr. 21, datë 17.1.2024**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME**
NË VENDIMIN NR. 150, DATË 13.3.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË
NORMAVE TË TRAJTIMIT ME
UNIFORMË TË USHTARAKËVE TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 150, datë 13.3.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve dhe të normave të trajtimit me uniformë të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

SHTOJCA NR. 12**NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR USHTARAKËT QË**
SHKOJNË ME MISION JASHTË VENDIT

Nr.	Artikujt e uniformave	Normat dhe afatet e përdorimit		Koment
		Sasia	Afati në muaj	
I.	UNIFORMA E STËRVITJES			
1.	Kostum stërvitje (xhaketë, pantallona, kapelë)	1	6	
2.	Bluzë me mëngë të gjata	2	6	
3.	Bluzë me mëngë të shkurtra	2	6	
4.	Pantallona të brendshme (benevrekë)	1	6	
5.	Rrip pantallonash	1	6	
6.	Rrip mesi	1	6	
7.	Çorape të gjata	4	6	
8.	Këpucë stërvitjeje lëkure	1	6	
9.	Këpucë stërvitjeje lëkure/najlon (verore)			Opsion në vend të këpucëve të stërvitjes të lëkurës
10.	Kapelë e madhe	1	6	
11.	Doreza luftimi	1	6	

Shënime:

- Gradat dhe dekoracionet që mbahen në uniformë janë pjesë e uniformës.
- Lloji i uniformës së stërvitjes, me të cilën do të kompletohen efektivet që shkojnë në misione jashtë vendi, me kohëzgjatje mbi 3 (tre) muaj, do të përcaktohet në urdhrat e ministrit të Mbrojtjes, rast pas rasti.

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Ushtarakët aktivë, që shërbejnë në Orkestrën Simfonike të Forcave të Armatosura, trajtohen me uniformë ushtarake, sipas shtojcës nr. 13, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

b) Në pikën 3, togfjalëshi “... në pikat 1 dhe 2 ...” zëvendësohet me “... në pikat 1, 2 dhe 2/1 ...”;

c) Shtojca nr. 12 zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër dhe emërtesë, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ç) Pas shtojcës nr. 12 shtohet shtojca nr. 13, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



**NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR USHTARAKËT AKTIVË TË ORKESTRËS
SIMFONIKE TË FORCAVE TË ARMATOSURA**

Nr.	Artikujt e uniformave	Normat dhe afatet e përdorimit		Komente
		Sasia	Afati në vite	
I.	UNIFORMA CEREMONIALE (TOKËSORE/AJRORE) PËR OFICERË, NËNOFICERË, USHTARË			
1.	Xhaketë	1	5	
2.	Pantallona	1	5	
3.	Fund			Opsion në vend të pantallonave për femrat
4.	Kapelë	1	5	
5.	Këmishë me mëngë të gjata	1	2	
6.	Këmishë me mëngë të shkurtra			Opsion në vend të këmishës me mëngë të gjata
II.	UNIFORMA CEREMONIALE DETARE E BARDHË PËR OFICERË, NËNOFICERË, USHTARË/DETARË			
1.	Xhaketë	1	5	
2.	Pantallona	1	5	
3.	Fund			Opsion në vend të pantallonave për femrat
4.	Këpucë të bardha për femra	1	5	
5.	Këpucë të bardha për meshkuj	1	5	
6.	Këmishë e bardhë me mëngë të shkurtra	1	2	
7.	Rrip pantallonash i bardhë	1	5	
III.	UNIFORMA E PUNËS TOKËSORE (VETËM PËR OFICERËT DHE NËNOFICERËT)			
1.	Xhaketë	1	2	
2.	Pantallona	2	2	
3.	Fund			Opsion në vend të pantallonave për femrat
4.	Kapelë pune	1	4	
5.	Beretë	1	3	Ngjyrë e zezë
6.	Kapelë zarf			Opsion në vend të beretës
7.	Këmishë me mëngë të gjata	2	1	
8.	Këmishë me mëngë të shkurtra	2	1	
9.	Bluzë pambuku me mëngë të shkurtra	2	1	
IV.	ARTIKUJ TË TJERË PËR UNIFORMËN CEREMONIALE DHE TË PUNËS			
1.	Kollare	1	3	
2.	Rrip pantallonash	1	3	
3.	Xhuboks (xhaketon)	1	3	
4.	Xhup dimëror	1	5	
5.	Pardesy			Opsion në vend të xhupit dimëror
6.	Pardesy kundër shiut	1	6	
7.	Pulovër	1	4	
8.	Pantallona verore	1	1	
9.	Fund veror			Opsion në vend të pantallonave verore për femrat
10.	Gete			Opsion në vend të çorapeve për femrat
11.	Çorape	4	1	
12.	Këpucë gjysma pune për meshkuj	1	1	
13.	Këpucë gjysma ceremoniale për meshkuj	1	5	Vetëm për ata që trajtohen me uniformë ceremoniale tokësore dhe ajrore
14.	Këpucë dimërore (meshkuj/femra)	1	3	
15.	Këpucë verore për femra	1	1	
16.	Çizme			Opsion në vend të këpucëve dimërore për femrat
17.	Kordon dekorativ i uniformës ceremoniale	1	10	
18.	Shenja e emrit	1	5	
19.	Suport për medaljet dhe dekoratat	1	10	
20.	Stema dhe distinktivë	1	5	Jepen kur emërohet për herë të parë
21.	Doreza lëkure	1	6	
22.	Doreza ceremoniale të bardha	1	3	
V.	UNIFORMA E STËRVITJES PËR OFICERË, NËNOFICERË, USHTARË			
	Uniforma e stërvitjes kamuflazh – “Woodland”			
1.	Kostum stërvitje (xhaketë, pantallona, kapelë)	1	3	
2.	Xhup dimëror	1	5	



3.	Bluzë “polo” me mëngë të shkurtra	1	2	
4.	Bluzë me mëngë të gjata	1	1	
5.	Bluzë me mëngë të shkurtra	1	1	
6.	Pantallona të brendshme (benevrekë)			
7.	Rrip pantallonash	1	5	
8.	Rrip mesi	1	7	
9.	Çorape të gjata	2	1	
10.	Këpucë stërvitjeje lëkure	1	5	
11.	Këpucë stërvitjeje lëkure/najlon (verore)			Opsion në vend të këpucëve të stërvitjes të lëkurës
VI.	UNIFORMA SPORTIVE PËR OFICERË, NËNOFICERË, USHTARË			
1.	Kostum sportiv (pantallona + bluzë me mëngë të gjata)	1	3	
2.	Kostum sportiv (pantallona të shkurtra + bluzë me mëngë të shkurtra)	1	3	
3.	Këpucë sportive (atlete)	1	3	
VII	UNIFORMA E DARKAVE ZYRTARE (VETËM PËR OFICERËT DHE NËNOFICERËT)			
1.	Kapelë	1	12	
2.	Xhaketë	1	12	
3.	Pantallona	1	12	Vetëm për meshkujt
4.	Fund	1	12	
5.	Këmishë me mëngë të gjata	1	12	
6.	Papion	1	12	
7.	Kostum civil (xhaketë, pantallona, fund)	1	7	Fundi, opsion për femrat në vend të pantallonave.

Shënime:

- Gradat dhe dekoracionet që mbahen në uniformë janë pjesë e uniformës.
- Trajtimi me uniformë ceremoniale i Orkestrës Simfonike të FA-së të bëhet e ndarë me tri llojet e uniformave: tokësore, ajrore, detare e bardhë, në proporcion të barabartë, ku ushtaraku që do të trajtohet me njërin nga llojet e uniformës ceremoniale do të vijojë të trajtohet gjithmonë vetëm me atë lloj uniforme dhe nuk do të trajtohet me asnjë lloj tjetër uniforme ceremoniale.
- Ushtarakët aktivë që emërohen për herë të parë në Orkestrën Simfonike të FA-së, në rast largimi nga Forcat e Armatosura, për arsye të ndërprerjes së njëanshme të kontratës, detyrohen të zhdëmtojnë vlerën e mbetur të uniformës me të cilën janë furnizuar.

VENDIM**Nr. 22, datë 17.1.2024**

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË
MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE
PUBLIKE PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2024, sipas lidhjes

nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për financat, Agjencia Shtetërore për Planifikimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC) dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet nga data 1 janar 2024.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



LIDHJA NR. 1
KALENDARI PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2024

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PËRKATËS
Janar	10	Ministria përgjegjëse për financat	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2025–2027
Janar	17	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2025–2027
Shkurt	8	SASPAC/KM	Përgatit dhe diskuton projekt-dokumentin e prioritetëve të politikave 2025–2027 me ndikim në tavanet buxhetore.
Shkurt	14	Ministria përgjegjëse për financat	Paraqet në KM tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2025–2027, për fazën strategjike
Shkurt	28	KM	Miraton listën unike të projekteve me Rëndësi Kombëtare
Shkurt	28	Ministria përgjegjëse për financat	Dërgon udhëzimin e përgatitjes së buxhetit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
Mars	8	KM	Paraqet për informacion në Kuvend Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2025–2027
Mars–prill	1 mars–22 prill	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
Prill	24 prill–25 prill	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile për PBA 2025–2027
Maj	1	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Paraqesin në MF kërkesat e tyre buxhetore
Maj	2 - 17 maj	Ministria përgjegjëse për financat	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
Maj	2 - 17 maj	SASPAC/KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e prioritetëve të politikave 2025–2027.
Maj	20 - 29 maj	Ministria përgjegjëse për financat	Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Maj	30 - 31 maj	Ministria përgjegjëse për financat	Prezanton dokumentin e PBA 2025–2027 me shoqërinë civile
Qershor	3	SASPAC/KM	Përgatit dokumentin e rishikuar të prioritetëve të politikave 2025–2027 me ndikim në tavanet buxhetore.
Qershor	3	Ministria përgjegjëse për financat	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (në rast se shihet e nevojshme)
Qershor	12	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (në rast se shihet e nevojshme)
Qershor	12	KM	Miraton dokumentin e rishikuar të prioritetëve të politikave 2025–2027 me ndikim në tavanet buxhetore.
Qershor	13	Ministria përgjegjëse për financat	Përgatit dokumentin e PBA 2025–2027 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2025–2027.
Qershor	19	Ministria përgjegjëse për financat	Paraqet dokumentin e PBA 2025–2027 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2025–2027, për shqyrtim dhe miratim në KM.
Qershor	26	KM	Miraton dokumentin e PBA 2025–2027 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2025–2027
Korrik	5	Ministria përgjegjëse për financat	I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e PBA 2025–2027
Korrik	10	Ministria përgjegjëse për financat	Dërgon udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit në fazën teknike, në të gjitha Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme
Korrik–gusht	10 korrik–30 gusht	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare
Shtator	2	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Paraqesin në MF kërkesat e rishikuara buxhetore
Shtator	4-13	Ministria përgjegjëse për financat	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	3-13	KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e rishikuar të prioritetëve të politikave 2025–2027.
Shtator	16-24	Ministria përgjegjëse për financat	Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Tetor	25 shtator–10 tetor	Ministria përgjegjëse për financat	Përgatit projektbuxhetin e vitit 2024, si dhe, dokumentin e rishikuar të PBA 2025–2027 dhe i paraqet për shqyrtim në KM.
Tetor	12	KM	Miraton projektbuxhetin e vitit 2024, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2025–2027
Tetor	19	Ministria përgjegjëse për financat	Dërgon për informacion në Kuvend një kopje të dokumentit të rishikuar të PBA 2025–2027, të miratuar nga KM-ja
Tetor	19	KM	I paraqet Kuvendit Projektbuxhetin e vitit 2025



VENDIM

Nr. 23, datë 17.1.2024

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
PRONËSISË INDUSTRIALE,
PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 191/b, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2024, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

Tabela nr. 1

**PLANI TË ARDHURA-SHPENZIME PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE,
PËR VITIN 2024**

Nr.	Të ardhurat	Në mijë lekë	Shpenzimet	Në mijë lekë
1	Të ardhura nga aktiviteti kryesor	185,000	Shpenzime personeli	74,600
2	Të trashëguara, transfera të jashtme, investime dhe projekte në vazhdim	14,810	Shpenzime operative dhe korrente	18,470
3	Marrëveshja e Madridit	68,000	Transfera korrente të jashtme	120,000
4	Marrëveshja e Hagës	1,400	Shpenzime kapitale	56,300
5	Të ardhura nga marrëveshja e shtirjes me ZEP	160		
	Totali i të Ardhurave	269,370	Totali i Shpenzimeve	269,370

VENDIM

Nr. 25, datë 17.1.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 255, DATË 9.5.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES
STRUKTURE E TË SHPËRBLIMIT
TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË
LARTË TË SPORTIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr.79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 255, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Kudo në përmbajtje të vendimit, emërtimi “Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë” zëvendësohet me fjalët “ministra përgjegjëse për sportin” dhe shkurtimi “MASR” zëvendësohet me “MAS”;

b) Në pikën 1 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
i. Pas shkronjës “a” shtohen shkronjat “a/1” dhe “a/2”, me këtë përmbajtje:

“a/1) Përfaqësuesi i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar anëtar;

a/2) Përfaqësuesi i Organizatës Kombëtare Shqiptare Anti Doping anëtar;”.

ii. Shkronjat “d”, “dh”, “e”, të pikës 1, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“d) Përfaqësuesi i Universitetit të Sporteve të Tiranës anëtar;

dh) Përfaqësuesi i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë anëtar;

e) Dy personalitete të sportit anëtarë;”.



2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 26, datë 17.1.2024

PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE SPITALORE NGA
SKEMA E DETYRUESHME E
SIGURIMEVE TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR, PËR VITIN 2024

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore të paketës së shërbimeve të ofruara në spitalet publike, sipas listës së shërbimeve në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Spitali e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me standardet, treguesit e cilësisë e të performancës, protokollat e diagnozës e të trajtimit, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

3. Buxheti për mbulimin e paketës së shërbimeve spitalore, sipas listës së shërbimeve që ofron çdo spital, ndahet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratat me spitalet për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore të ofruara prej tyre, në përputhje me indikatorët e performancës spitalore.

5. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon paketën e shërbimeve spitalore të kontraktuara me këto metoda:

a) Buxhetim me zëra shpenzimesh, për:

i. paga dhe shpenzime të tjera lidhur me pagën e personelit;

ii. kontribute për sigurime shëndetësore e shoqërore të personelit;

iii. mallra e shërbime të tjera.

b) Buxhetim për pagesën e paketave të shërbimeve me çmime të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Buxheti detajohet për çdo spital në zëra shpenzimesh me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;

c) Buxhetim për spitalet Durrës e “Memorial” Fier. Detajimi në zëra shpenzimesh i buxhetit miratohet nga bordet e këtyre spitaleve. Fondi financon dy spitalet nëpërmjet transfertave në llogaritë bankare që spitalet kanë në bankat e nivelit të dytë.

6. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon spitalet, në zbatim të vendimit nr. 258, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës”. Fondi rishikon financimin e spitaleve për këtë kontratë gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale.

7. Spitali është përgjegjës për zbatimin e buxhetit të kontraktuar, sipas zërave të përcaktuar të buxhetit, në përputhje me indikatorët dhe aktivitetin e shërbimit spitalor.

8. Rishpërndarja e buxhetit ndërmjet spitaleve bëhet brenda një kufiri prej 3% të buxhetit të spitaleve, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

9. Një fond jo më i madh se 30% e buxhetit vjetor, i planifikuar për shërbimet spitalore, mbahet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për ta shpërndarë gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, përkatësisht, për:

a) financimin e shërbimit spitalor gjatë vitit;

b) pagesat e paketave të shërbimeve të veçanta, të ofruara nga shërbimet spitalore, publike e jopublike, brenda vendit, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;



c) pagesat për kujdes shëndetësor në institucione jopublike, brenda e jashtë vendit, sipas miratimit, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) pagesat për kujdes shëndetësor, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;

d) pagesat e shërbimeve të kryera për llogari të spitaleve publike nga operatorë të kontraktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,

dh) transfertat për individët (mjekë në shërbimet spitalore).

10. Shpenzimet kapitale për investimet në spitale mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor vlerëson kërkesat e spitaleve (rajonale/bashkiake) për investimet dhe ia paraqet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratim. Spitalet universitare paraqesin kërkesën për investime në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

11. Burime të tjera financimi për spitalet janë fondet e krijuara nga të ardhurat e realizuara gjatë veprimtarisë së tyre dhe nga dhurimet. Përdorimi i tyre bëhet tërësisht nga vetë spitali, si pjesë e kostos së shërbimit, bazuar në procedurat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Këto të ardhura vlerësohen si të ardhura jashtë limitit, të cilat mbarten në vitin buxhetor pasardhës.

12. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për raste të vlerësuara nga ajo ose me kërkesë të autoriteteve kontraktuese, spitaleve, mund të zhvillojë procedura të përqendruara prokurimi për disa mallra, shërbime dhe investime.

13. Spitali zbaton sistemin e referimit dhe tarifën për shërbimet me pagesë, të miratuara nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

14. Numri i përgjithshëm i punonjësve të spitaleve është 13 200 (trembëdhjetë mijë e dyqind) veta, nga të cilët 141 (njëqind e dyzet e një) punonjës në Spitalin Universitar të Traumës, të cilët paguhen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

15. Për raste të veçanta të mungesës së mjekut specialist në shërbime të ndryshme të spitaleve rajonale, bashkiake, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, brenda numrit të përgjithshëm të personelit spitalor, urdhëron kontraktimin, për një periudhë të caktuar, të mjekëve specialistë. Mjekët e përcaktuar në këtë pikë, përveç pagës, trajtohen financiarisht me një bonus deri në 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë në muaj. Vlera e bonusit

përcaktohet, rast pas rasti, nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bazuar në vlerësimin e komisionit përkatës. Ky bonus, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, trajtohet sipas shkronjës “e”, të pikës 2, të kreut II, të vendimit nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar.

16. Mjekët e kontraktuar, sipas pikës 15, të këtij vendimi, nuk e përfitojnë shpërblimin sipas shkronjave “a” e “b”, të pikës 9/1, të vendimit nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës”, të ndryshuar.

17. Për spitalet rajonale, bashkiake, kur nuk plotësohen nevojat me personel mjek të strukturës, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale urdhëron kontraktimin e mjekëve të përgjithshëm pranë shërbimit të urgjencës.

18. Numri i pedagogëve me kontratë shërbimi për spitalet universitare miratohet çdo vit nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Masa e shpërblimit mujor të mjekëve pedagogë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, bazohet në aktivitetin mjekësor e në kohën e angazhimit në strukturat shëndetësore universitare dhe nuk mund të jetë më e lartë se masa e shpërblimit mujor të drejtuesit të shërbimit me gradën “doktor i shkencave”. Pagesa e tyre bëhet nga buxheti për shërbimet e spitalit.

19. Financimi i institucioneve dhe i shërbimeve, të përcaktuara në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor vetëm kundrejt shtesave përkatëse në buxhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

20. Vendimi nr. 23, datë 18.1.2023, i Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e



sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2023”, të ndryshuar, shfuqizohet.

21. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2024.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA NR. 1
LISTA E SHËRBIMEVE SPITALORE QË
DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR

I. SPITALET UNIVERSITARE

1. Shërbimi i kardiologjisë 1;
2. Shërbimi i kardiologjisë 2;
3. Shërbimi i kardiokirurgjisë;
4. Shërbimi i kirurgjisë angiovaskulare;
5. Shërbimi i hematologjisë;
6. Shërbimi i gastro-hepato-enterologjisë;
7. Shërbimi i endokrinologjisë;
8. Shërbimi i nefrologjisë dhe hemodializës;
9. Shërbimi i anestezi-reanimacionit;
10. Shërbimi i urgjencave polivalente;
11. Shërbimi i hipertonisë dhe i mjekësisë interne;
12. Shërbimi i alergologjisë;
13. Shërbimi i reumatologjisë;
14. Shërbimi i dermatologjisë;
15. Shërbimi i traumatologjisë;
16. Shërbimi i ortopedisë;
17. Shërbimi i okulistikës;
18. Shërbimi i ORL-së;
19. Shërbimi i kirurgjisë oro-maksilo-faciale (OMF);
20. Shërbimi i urgjencës kirurgjikale;
21. Shërbimi i kirurgjisë digjestive;
22. Shërbimi i urologjisë;
23. Shërbimi i djegie-plastikës;
24. Shërbimi i neurologjisë;
25. Shërbimi neurovaskular (stroke dhe poststroke);
26. Shërbimi i neurokirurgjisë;
27. Shërbimi i onkologjisë;
28. Shërbimi i sëmundjeve infektive;

29. Shërbimi i pediatriisë së specialiteteve;
 30. Shërbimi i onkohematologjisë pediatrike;
 31. Shërbimi i pediatriisë infektive;
 32. Shërbimi i urgjencës dhe i pediatriisë së përgjithshme;
 33. Shërbimi i kirurgjisë infantile;
 34. Shërbimi i reanimacionit pediatrik;
 35. Shërbimi i laboratorëve (klinikë-biokimikë, mikrobiologjikë, imunologjikë, anatomisë patolo-gjike);
 36. Shërbimi i gjenetikës mjekësore;
 37. Shërbimi i imazherisë dhe i mjekësisë nukleare;
 38. Shërbimi i mjekësisë rehabilituese;
 39. Shërbimi i statistikave;
 40. Shërbimi i pneumologjisë;
 41. Kirurgjia torakale;
 42. Shërbimi i gjinekologjisë;
 43. Shërbimi i obstetrikës;
 44. Shërbimi i patologjisë së barrës;
 45. Shërbimi i neonatologjisë;
 46. Shërbimi i farmacisë;
 47. Shërbimi i konsultave të specializuara ambulatorë;
 48. Shërbimi i toksikologjisë klinike;
 49. Shërbimi i psikiatriisë (QSUT);
 50. Kontrolli i infeksioneve spitalore;
 51. Shërbimi i urgjencës paraspitalore;
 52. Banka e gjakut.
- II. QENDRA SPITALORE RAJONALE
- II.A. Shërbimet e qendrës spitalore rajonale përcaktohen rast pas rasti në urdhrin e ministrit për ngritjen e qendrës spitalore rajonale.
- II/A. QENDRA SPITALORE RAJONALE E TIRANËS “SHEFQET NDROQI”
1. Shërbimi i urgjencës;
 2. Shërbimi Universitar i Sëmundjeve Polmonare;
 3. Shërbimi i mjekësisë interne;
 4. Shërbimi i kardiologjisë dhe hemodinamikës;
 5. Shërbimi i kardiokirurgjisë;
 6. Shërbimi i kirurgjisë abdominale dhe ortopedike;
 7. Shërbimi i kirurgjisë torakale;
 8. Shërbimi i anestezi-reanimacionit;
 9. Shërbimi imazherisë;
 10. Shërbimi i referencës së tuberkulozit;
 11. Shërbimi i laboratorit;
 12. Shërbimi i konsultave;
 13. Shërbimi i pediatriisë;



14. Shërbimi i farmacisë;
15. Njësi komunitare lindjeje;
16. Riaftësim dhe rehabilitim.

III. SPITALET NË NIVEL QARKU (SPITALET RAJONALE)

Spitalet publike të përgjithshme në nivel qarku ofrojnë:

1. Shërbimin e urgjencës;
2. Shërbimin e mjekësisë së përgjithshme;
3. Shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme, ortopedi-traumatologjisë, urologjisë, ORL, okulistikës, angiologjisë, *max-facial*;
4. Shërbimin e obstetrikë-gjinekologjisë;
5. Shërbimin e neonatologjisë;
6. Shërbimin e pediatriisë;
7. Shërbimin e imazherisë;
8. Shërbimin e mjekësisë rehabilituese;
9. Shërbimin e anatomisë dhe histologjisë patologjike;
10. Shërbimin e laboratorëve kliniko-biokimikë të mikrobiologjisë;
11. Shërbimin e anestezi-reanimacionit;
12. Shërbimin e farmacisë;
13. Shërbimin e onkologjisë (kimioterapisë, kujdesi paljativ);

14. Kontrollin e infeksioneve spitalore;
15. Shërbimin psikosocial;
16. Shërbimin e konsultave të specializuara (poliklinika e specialiteteve);

17. Bankën e gjakut.

IV. SPITALET NË NIVEL BASHKIE

Spitalet publike të përgjithshme në nivel bashkie ofrojnë:

1. Shërbimin e urgjencës;
2. Shërbimin e mjekësisë së përgjithshme;
3. Shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme;
4. Shërbimin e pediatriisë dhe obstetrikë-gjinekologjisë, neonatologji;
5. Shërbimin imazherisë;
6. Shërbimin e laboratorëve kliniko-biokimikë të mikrobiologjisë;
7. Shërbimin e anestezi-reanimacionit;
8. Shërbimin e farmacisë;
9. Shërbimin ambulator të specializuar;
10. Bankën e gjakut.

V. SPITALET DITORE

1. Ndihmë e parë mjekësore për trajtim dhe kurim brenda 24 orëve.

SHTOJCA NR. 2 BUXHETI I SHËRBIMIT SPITALOR 2024

në 000 lek

INSTITUCIONET	ARTIKUJT					TOTAL
	ART. 600	ART. 601	ART. 602	ART. 602 PPP LABORATORË	ART. 604	
BERAT	360,000	59,500	180,000	61,000		660,500
BULQIZË	95,000	15,700	30,000			140,700
DELVINË	43,500	7,200	7,000			57,700
DEVOLL	58,000	9,650	12,000			79,650
DIBËR	326,500	53,500	135,000	31,000		546,000
ELBASAN	584,700	96,350	250,000	100,000		1,031,050
FIER	465,000	76,000	218,000	112,000		871,000
GRAMSH	148,300	24,000	35,000			207,300
GJIROKASTËR	276,500	44,200	120,000	34,000		474,700
HAS	56,500	9,300	16,000			81,800
KAVAJË	11,800	1,950	2,000			15,750
KOLONJË	97,300	15,700	20,000			133,000
KORÇË	526,300	86,700	295,000	80,000		988,000
KRUJË	149,500	24,600	32,000			206,100
KUÇOVË	77,000	12,200	20,000			109,200
KUKËS	321,500	52,750	126,000	34,000		534,250
KURBIN	109,000	18,200	37,000			164,200
LEZHË	333,000	55,000	180,000	62,000		630,000
LIBRAZHID	180,500	29,650	54,000			264,150
LUSHNJË	277,000	45,750	107,000	45,000		474,750
MALËSI E MADHE	26,700	4,450	6,600			37,750
MALLAKASTËR	51,200	8,500	13,000			72,700
MAT	163,500	26,550	40,000			230,050
MIRDITË	124,300	20,400	30,000			174,700
PEQIN	45,000	7,400	7,500			59,900
PËRMET	94,500	15,500	35,000			145,000



POGRADEC	208,000	34,000	84,000			326,000
PUKË	111,500	17,750	40,000			169,250
SARANDË	201,500	32,600	120,000	33,000		387,100
SKRAPAR	95,800	15,500	18,000			129,300
SHKODËR	689,000	112,550	290,000	65,000		1,156,550
TEPELENË	110,500	17,400	16,000			143,900
QSUT	3,057,700	495,210	3,500,000	820,000		7,872,910
SUOGJ “MBRETËRESHA GERALDINË”	364,700	56,550	300,000	30,000		751,250
SUOGJ “KOÇO GLIOZHENI”	301,700	47,700	300,000	30,000		679,400
SU “SHEFQET NDROQI”	41,000	6,600				47,600
QSR “SHEFQET NDROQI”	565,600	89,700	450,000	62,000		1,167,300
SU TRAUMA	175,200	27,200	350,000	55,000		607,400
TROPOJË	127,700	21,100	40,000			188,800
VLORË	506,300	83,650	360,000	65,000		1,014,950
“MEMORIAL” FIER					1,000,000	1,000,000
DURRËS				73,000	1,200,000	1,273,000
Paketat e shërbimeve					3,204,135	3,204,135
Transferta për individët (mjekë specialistë)					30,000	30,000
Trajtime me VKM					30,000	30,000
Pagesat e shërbimeve PPP					2,676,104	2,676,104
Rezervë				58,000	989,941	1,047,941
TOTAL	11,558,300	1,878,210	7,876,100	1,850,000	9,130,180	32,292,790

SHTOJCA NR. 3

LISTA E INSTITUCIONEVE, QË NUK DO
TË FINANCOHEN NGA FONDI I
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR

1. Spitali psikiatrik Vlorë;
2. Spitali psikiatrik Elbasan;
3. Shërbimet e shëndetit mendor në rrethe;
4. Shërbimi i psikiatrisë Shkodër;
5. Qendra Kombëtare e Ri aftësimit, Mirërritjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve;
6. Shërbimi Kombëtar i Transfuzionit;
7. Qendra Kombëtare Biomjekësore.

URDHËR

Nr. 19, datë 15.1.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË URDHRIN NR. 267, “MBI MIRATIMIN
E RREGULLORES PËR MËNYRËN,
KRITERET DHE PROCEDURAT E
KATEGORIZIMIT TË STRUKTURAVE
AKOMODUESE”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 20.10.2016, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, të ndryshuar,

Faqe | 2210

URDHËROJ:

Në tekstin e rregullores së miratuar me urdhrin nr. 267, “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshime si më poshtë vijon:

1. Shkronja “c” e pikës 1, të nenit 4, ndryshon si vijon:

“c) Faza e tretë përfshin verifikimin në terren, rast pas rasti, të të dhënave të vetëdeklarimit nga inspektorati përgjegjës i turizmit, nëse Komisioni i Standardizimit e kërkon këtë proces.”.

2. Neni 6 ndryshon si më poshtë:

“Neni 6

**Dokumentet e aplikimit për pajisje me
certifikatë kategorizimi**

1. Dokumentacioni që duhet të paraqesë subjekti:

a) Certifikata e përdorimit të ndërtimit lëshuar nga organi kompetent ose një nga dokumentet më poshtë:

i. certifikata e pronësisë;

ii. kartela e pasurisë;

iii. kontrata e qirasë ose e përdorimit me pronarin e ndërtesës;

b) Planimetria e strukturës akomoduese;

c) Foto të ambienteve brenda dhe të jashtme të strukturës.



2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit siguron nëpërmjet portalit *e-Albania* dokumentacionin si vijon:

a) Vërtetim për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik/juridik me objekt veprimtarie si strukturë akomoduese;

b) Vërtetim i gjendjes gjyqësore të Subjektit aplikues/aksionarit kryesor; pronarit/administratort;

c) Vërtetimi që struktura plotëson kushtet për masat e mbrojtjes nga zjarri lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri;

d) Vërtetim që struktura plotëson kushtet higijeno-sanitare, lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik.”.

3. Neni 7 ndryshon si më poshtë:

“Neni 7

Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit për kategorizimin e strukturave akomoduese

1. Komisioni i Standardizimit brenda 10 ditëve nga data e depozitimit të aplikimit për pajisje me certifikatë kategorizimi në portalin *e-Albania*, shqyrton dhe vlerëson aplikimin në përmbushjen e kriterëve për kategorizimin e strukturave akomoduese.

2. Komisioni i Standardizimit, në rast të konstatimit të mangësive, njofton brenda 2 ditëve nga data e shqyrtimit të aplikimit, aplikuesin për plotësimin e dokumentacionit.

3. Aplikuesi duhet të plotësojë dokumentacionin brenda 10 ditëve nga data e njoftimit për mangësitë e konstatuara.

4. Në rast se Komisioni i Standardizimit gjatë shqyrtimit të aplikimit konstaton parregullsi apo lëndin dyshime të arsyeshme për të dhënat e deklaruara, i kërkon inspektoratit përgjegjës të turizmit verifikimin në terren të të dhënave. Komisioni i Standardizimit nëpërmjet sekretarisë teknike, njofton aplikuesin dhe koordinon vizitën në terren.

5. Inspektorati përgjegjës i turizmit i paraqet Komisionit të Standardizimit raportin e gjetjeve të konstatuara në terren, brenda 5 ditëve nga dita e vizitës në terren.

6. Afati i parashikuar në pikën 1 mund të shtyhet, në mënyrë të arsyetuar, por jo më shumë se 30 ditë, duke i dërguar aplikuesit njoftimin në sistemin *e-*

Albania, jo më vonë se përfundimi i afatit i parashikuar në pikë 1 të këtij neni.

7. Në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe të vlerësimit, Komisioni i Standardizimit merr vendim për lëshimin ose jo të certifikatës së kategorizimit të strukturës akomoduese dhe e përcjell për miratim pranë ministrit.”.

4. Neni 8 ndryshon si më poshtë:

“Neni 8

Certifikata e kategorizimit të strukturës akomoduese

1. Certifikata e kategorizimit të strukturës akomoduese përmban:

a) Emërtesën e strukturës akomoduese;

b) Adresën e strukturës akomoduese;

c) Kategorinë;

d) Datën e lëshimit të certifikatës së kategorizimit;

e) Nënshkrimin e ministrit ose të personit të autorizuar prej tij.

2. Certifikata e kategorizimit gjenerohet *online* në sistemin *e-Albania*.

3. Certifikata e kategorizimit, sipas formatit dhe modelit, shtojca 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje është tregues i llojit të strukturës akomoduese dhe afishohet në recepsion/zonën e pritjes së strukturës akomoduese.

4. Lloji i kategorisë së strukturës akomoduese, sipas certifikatës së kategorizimit, vendoset në hyrjen kryesore/fasadën e strukturës akomoduese.

5. Certifikata e kategorizimit të strukturës akomoduese regjistrohet në Regjistrin Qendror të Turizmit, i administruar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.”.

5. Neni 9 ndryshon si më poshtë:

“Neni 9

Ndryshimi i kategorisë së strukturës akomoduese

1. Aplikuesi mund të aplikojë për ndryshimin e kategorisë së një strukture akomoduese në çdo kohë që e çmon se ndërhyrjet dhe ndryshimet në objekt ndikojnë në ndryshimin e kategorisë së strukturës akomoduese.

2. Aplikimi për ndryshimin e kategorisë së strukturës akomoduese kryhet *online* nëpërmjet



vetëdeklarimit të aplikuesit, së bashku me foto që vërtetojnë ndërhyrjet apo ndryshimet në objekt.

3. Komisioni i Standardizimit rishqyrton statusin e kategorizimit brenda 10 ditëve nga data e aplikimit për ndryshim të kategorisë së strukturës akomoduese.”.

6. Shtojca 1 e rregullores “Certifikata e kategorizimit të strukturës akomoduese” zëvendësohet me shtojcën, sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

SHTOJCA 1


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
CERTIFIKATË KATEGORIZIMI
STRUKTURË AKOMODUESE
Kjo certifikatë lëshohet për strukturën akomoduese:
<i>“Emërtesa e strukturës”</i>
Adresa: _____
Kategoria: _____
Lëshuar më ____ / ____ /20 ____
Nr. Regj. ____ /20 ____
MINISTRI / PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ



VENDIM

Nr. 3, datë 15.12.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji i Posaçëm i Apelit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	kryetar;
Mimoza Tasi	anëtare;
Albana Shtylla	anëtare;
Ina Rama	anëtare;
Natasha Mulaj	anëtare;
Rezarta Schuetz	anëtare,

- mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, në datat 9.11.2023 dhe 15.12.2023, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me sekretare gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 2/2023, datë 30.3.2023, që i përket:

ANKUESE: Majlinda Salillari (Maçellari).

SUBJEKT I INTERESUAR: Këshilli i Lartë Gjyqësor.

OBJEKTI I ANKIMIT: Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 117, datë 17.9.2001, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

BAZA LIGJORE E ANKIMIT: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; neni 6 i KEDNJ-së; nenet 40, 41, 43, 44, 46 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (i shfuqizuar); nenet 59, 80 e vijues, 93 e vijues, 105, 108, 116, 117 të Kodit të Procedurave Administrative (ligji nr. 8485, datë 12.5.1999, i shfuqizuar); nenet 24, 33 të ligjit nr. 8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së” (i shfuqizuar).

KOLEGJI I POSAÇËM I APELIT,

pasi shqyrtoi pretendimet e ankueses Majlinda Salillari (Maçellari), e cila ka kërkuar pranimin e ankimit, prapësimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë Gjyqësor, që ka kërkuar mospranimin e ankimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Ankuesja Majlinda Salillari (Maçellari) ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit

Gjyqësor Pogradec nga viti 1990 deri në muajin tetor 2001. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 117, datë 17.9.2001, ka vendosur: *‘Majlinda Maçellari, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, për kryerje të veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, shkarkohet nga detyra e gjyqtarës’.*

2. Ankuesja në datën 19.5.2016 i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 117, datë 17.9.2001, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pasi është dhënë në kundërshtim me ligjin material nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kushtetutën e Shqipërisë dhe nenin 6 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

3. Gjykata e Lartë me vendimin nr. {**} akti, datë 20.1.2023, ka vendosur nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes me nr. {***}, datë regjistrimi 19.5.2016, dhe dërgimin e akteve për shqyrtim Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

4. Me shkresën nr. {***} akti, datë 28.2.2023, Gjykata e Lartë ka përcjellë në Kolegjin e Posaçëm të Apelit dosjen nr. 1, datë 20.1.2023, që u përket palëve: Kërkuese (ankuese) Majlinda Maçellari, Subjekt i interesuar Këshilli i Lartë Gjyqësor (ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë).

5. Në datën 27.3.2023 ankuesja Majlinda Salillari (Maçellari), e përfaqësuar me prokurë nga studio ligjore “{***}”, i është drejtuar Kolegjit me kërkesë për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 117, datë 17.9.2001, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

6. Në përgjigje të kërkesës së Kolegjit nr. {***} prot., datë 29.3.2023, për plotësim aktesh, ankuesja ka depozituar në datën 30.3.2023, prokurën e posaçme nr. {***} rep., {***} kol., datë 26.7.2022.

7. Ankimi i paraqitur ndaj vendimit nr. 117, datë 17.9.2001, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është regjistruar në Kolegjin në regjistrin e çështjeve të Juridiksionit Disiplinor me nr. 2/2023(JD), datë 30.3.2023.

8. Kolegji për Shqyrtimin Paraprak, bazuar në nenin 31/1, pika 2, lexuar në harmoni me parashikimet e nenit 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, si dhe në referim të nenit 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, me Vendimin Nr. {***}, datë 13.6.2023, ka vendosur



kalimin për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve të çështjes (JD) nr. 2/2023, datë 30.3.2023, që i përket kërkesës së ankueses Majlinda Salillari (Mañçellari) ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 117, datë 17.9.2001.

9. Këshilli i Lartë Gjyqësor, në datën 27.7.2023 ka depozituar në Kolegj prapësimet lidhur me çështjen (JD) nr. 02/2023, datë 30.3.2023, ndërsa në datën 21.11.2023 ankuesja Majlinda Salillari (Mañçellari), nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, avokatit E. D., ka depozituar parashtimet e saj.

I. Pretendimet e ankueses Majlinda Salillari (Mañçellari) në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

10. Ankuesja Majlinda Salillari (Mañçellari) (në vijim “ankuesja”), në ankimin e paraqitur në Kolegj, si dhe në parashtimet e datës 21.11.2023, ka paraqitur qëndrimin e saj ndaj vendimit nr. 117, datë 17.9.2001, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), duke parashtuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

a) Parashtimi i fakteve

11. Ankuesja ka ushtruar detyrën si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, nga viti 1990 deri në muajin tetor 2001, kur është shkarkuar nga detyra me vendimin nr. 117, datë 17.9.2001, të KLD-së. Shkarkimi nga detyra është i lidhur me vendimarrjen e saj si gjyqtare në një proces penal ndaj disa shtetasve të akuzuar për veprën penale “Trafikim i mjeteve motorike në bashkëpunim”. Me vendimin nr. {***}, datë 31.7.2001, ankuesja ka vlerësuar të paligjshëm ndalimin e shtetasve G.S., R.K. e S.Ç., ndërkohë që ka vlerësuar të ligjshëm ndalimin e shtetasit italian G.M., duke caktuar masën e sigurimit personal arrest me burg. Më pas, me vendimin nr. {***}, datë 16.8.2001, ankuesja për këtë shtetas ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit arrest me burg, me atë të detyrim paraqitjeje.

12. Ministri i drejtësisë, me shkresën nr. {***} prot., datë 22.8.2001, i është drejtuar Kryeinspektorit të KLD-së, me kërkesën për të verifikuar informacionin për shkelje të ligjit nga ana e gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Majlinda Mañçellari. Nga inspektorët e Inspektoratit të KLD-së është hartuar relacioni i datës 27.8.2001, mbi verifikimin e të dhënave për shkelje ligji për gjyqtaren Majlinda Mañçellari, ndërkohë që nuk ishin shqyrtuar akoma rekursitet respektive të organit të akuzës për të dy vendimet (Gjykata e Lartë ka disponuar me vendim në datën

6.9.2001). Me shkresën nr. {***} prot., datë 4.9.2001, ministri i drejtësisë i është drejtuar Presidentit, me cilësinë e Kryetarit të KLD-së, si dhe Inspektoratit të KLD-së me kërkesë për nisjen e procedimit disiplinor për gjyqtaren Majlinda Mañçellari, duke propozuar shkarkimin e saj nga detyra. Në përfundim KLD-ja, me vendimin nr. 117, datë 17.9.2001, ka vendosur shkarkimin nga detyra të gjyqtarës Majlinda Mañçellari, për kryerjen e veprimeve të kundërligjshme në përmbushje të rregullt të detyrës.

13. Ministri i drejtësisë, me shkresën nr. {***} prot., datë 26.9.2001, i ka komunikuar vendimin e KLD-së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, por jo vetë gjyqtarës individualisht. Në bazë të kësaj shkrese, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec i ka ndërprerë marrëdhëniet financiare ish-gjyqtarës. Për këtë shkak, ankuesja në datën 19.5.2016 u është drejtuar Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me kërkesën me objekt “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 117, datë 17.9.2001, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, duke parashtuar faktin se ky vendim nuk i është njoftuar asnjëherë.

14. Për herë të parë, sipas ankueses, vendimi i është vënë në dispozicion me anë të shkresës kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 11.7.2016, të KLD-së, në përmbajtje të së cilës evidentohet se *Majlinda Mañçellari, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, shkarkohet nga detyra e gjyqtarës.*

b) Themeli i kërimit

15. Ankuesja pretendon se gjatë shqyrtimit të çështjes së saj në KLD i është cenuar e drejta për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, si dhe nuk janë respektuar parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Trajtimi në KLD i kërkesës së ministrit të drejtësisë, për fillimin e procedurës dhe shkarkimin e saj nga detyra, vjen në kundërshtim me ligjin dhe praktikën gjyqësore.

16. Vendimit të KLD-së i mungon arsyetimi si një element i domosdoshëm për një proces të rregullt, pasi subjekti duhet të njihet me shkaqet e shkarkimit edhe për efekt ankimi. Vendimi nr. 117, datë 17.9.2001, i KLD-së është një akt administrativ individual dhe ligjvënës, referuar neneve 108 dhe 116 të Kodit të Procedurave Administrative (ligji nr. 8485, datë 12.5.1999), e ka konsideruar arsyetimin një rrethanë të domosdoshme, mungesa e të cilit e bën këtë akt administrativ absolutisht të pavlefshëm



(kur akti i nxjerrë është në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji). Ankuesja i referohet vendimit nr. 11/2003, të Gjykatës Kushtetuese sipas të cilit [...] Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kanë argumentuar se cilat janë shkaqet e shkeljeve disiplinore që i atribuohen kërkuarit. Ato nuk janë shprehur nëse këto akte ose shkelje, janë kryer si rezultat i veprimeve me dashje që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e tij si gjyqtar, apo janë shkelje e gabime të një natyre më të lehtë [...].

17. Ankuesja pretendon se asaj i është njoftuar vendimarrja, por jo vendimi. Vendimi nr. 117, datë 17.9.2001, i KLD-së i është vënë në dispozicion nga ky organ pas kërkesës së saj, me shkresën nr. {***} prot., datë 11.7.2016, dhe në referim të standardit ligjor nuk ka njoftim ose njoftimi nuk do të konsiderohet i realizuar, për sa kohë që nuk është komunikuar një akt në kuptimin formal. Ligji është tepër i qartë kur trajton mënyrën e kundërshtimit të vendimit të KLD-së për shkarkimin e gjyqtarit. Neni 46 i ligjit nr. 8436/1998 parashikonte se *gjyqtari kur shkarkohet nga detyra [...] ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë [...]*. Sipas ankueses, përderisa ligji i kohës nuk parashikonte ndonjë mënyrë të posaçme njoftimi, atëherë si referencë duhet të merren nenet 58¹ dhe 59² të Kodit të Procedurave Administrative për njoftimin e akteve individuale.

18. Ankuesja, duke pretenduar pavlefshmëri absolute të vendimit nr. 117, datë 17.9.2001, të KLD-së, bazuar në nenin 117 të Kodit të Procedurave Administrative të vitit 1999, i cili parashikon se 2. *Secila palë e interesuar mund të kërkojë që akti administrativ të shpallet absolutisht i pavlefshëm. Kërkesa në fjalë mund të bëhet në çdo kohë. Organi*

¹ Neni 58 - Përmbajtja e njoftimit - 1. Njoftimi duhet të përmbajë sa më poshtë: a) tekstin e plotë të aktit administrativ; b) emrin e personit përgjegjës për aktin dhe datën e këtij të fundit; c) organin që ka juridiksion për të vendosur për apelin kundër aktit dhe afatet kohore për këtë qëllim, në rast se akti nuk mund të apelohe në rrugë gjyqësore. 2. Teksti i plotë i aktit mund të zëvendësohet me një përmbledhje të përmbajtjes dhe objektit të tij në rastet kur akti ka plotësuar të gjitha kërkesat e formuluar nga palët e interesuara ose kur akti ka të bëjë me marrjen e masave procedurale. Neni 59 – Afatet kohore për njoftimet – Përveç rasteve kur me ligj vendoset ndryshe, aktet administrative duhet të njoftohen brenda 8 ditësh. Afatet fillojnë të llogariten që nga data që pason ditën në të cilën nxirret akti ose data kur palët e interesuara marrin pjesë në procedimin administrativ.

² Neni 59 – Afatet kohore për njoftimet - Përveç rasteve kur me ligj vendoset ndryshe, aktet administrative duhet të njoftohen brenda 8

administrativ kompetent, me nismën e tij, mundet të deklarojë një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm në çdo kohë, parashtron në ankim se për sa kohë nuk ka pasur një akt të vlefshëm, pavlefshmëria e tij mund të ngrihet në çdo kohë. Rrjedhimisht, nuk ka asnjë shkak për të penalizuar ankuesen për ushtrimin e kërkesës tej afatit 10-ditor të ankimit që parashikonte ligji i kohës.

II. Prapësimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me pretendimet e ankueses Majlinda Salillari (Maçellari)

19. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KL.GJ”), lidhur me shkaqet e ankimit në mënyrë të përmblëdhur, ka parashtruar se:

19.1 Lidhur me pretendimin e ankueses se nuk është dëgjuar para se të gjykohej, rezulton se procedimi disiplinor, si dhe dhënia e masës disiplinore të *shkarkimit nga detyra* ka ndjekur rigorozisht kërkesat e ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në kohën e procedimit disiplinor. Në zbatim të nenit 44, paragrafi i parë³ të këtij ligji, procedimi disiplinor është vënë në lëvizje nga ministri i drejtësisë me shkresën e tij nr. {***} prot., datë 22.8.2001. Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të detyrave të parashikuara në nenin 16 të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”⁴, ka kryer verifikimet e kërkuara nga ministri lidhur me vendimet gjyqësore të cituara në shkresë. Në përfundim të inspektimit, Inspektorati i KLD-së ka përgatitur relacionin me shkrim, të cilin, në zbatim të nenit 16, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr. 8811/2001, ia ka nisur për vlerësim ministrit të drejtësisë. Bazuar në relacionin e hartuar nga

ditësh. Afatet fillojnë të llogariten që nga data që pason ditën në të cilën nxirret akti ose data kur palët e interesuara marrin pjesë në procedimin administrativ.

³ Neni 44: Procedimi disiplinor për gjyqtarët vihet në lëvizje nga ministri i drejtësisë.

⁴ Vihet re se ankuesja në parashtrimet e saj, si dhe KL.GJ-ja në prapësime, gabimisht i referohen ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, ndërkohë që rezultojnë se ky ligj në kohën e dhënies së vendimit të KLD-së, në datën 17.9.2001, nuk kishte hyrë akoma në fuqi. Ky ligj është botuar në fletoren zyrtare nr. 9, të vitit 2002 dhe ka hyrë në fuqi në datën 7.5.2002. I vetmi ligj i kohës mbi të cilin trajtohet ankimimi është ligji nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.



Inspektorati dhe gjetjet e konstatuara, ministri i drejtësisë ka paraqitur në KLD kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor dhe në përfundim të shqyrtimit ka propozuar marrjen e masës disiplinore *shkarkim nga detyra*. KLD-ja, sipas përcaktimeve të nenit 33 të ligjit nr. 8811/2001, ka shqyrtuar procedimin disiplinor në seancën e datës 17.9.2001. Në këtë seancë ka qenë e pranishme dhe ankuesja, e cila ka paraqitur kundërshtimet e saj ndaj kërkesës së ministrit të drejtësisë. KLD-ja, në zbatim të nenit 33/2 të ligjit nr. 8811/2001, pasi ka dëgjuar ministrin e drejtësisë dhe më pas gjyqtaren, si dhe pasi ka zhvilluar diskutimin përfundimtar, me vendimin nr. 117, datë 17.9.2001, ka vendosur *shkarkimin nga detyra të ankueses*.

19.2 Pretendimi i ankueses se nuk i është komunikuar vendimi nr. 117, datë 17.9.2001, i KLD-së është i pabazuar, pasi ky vendim i është komunikuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe gjyqtarës Majlinda Mançellari, në të njëjtën shkresë me nr. {***} prot., datë 26.9.2001, të ministrit të drejtësisë e në vazhdim ankuesja nuk e ka ushtruar më detyrën e gjyqtarit, fakt që rrëzon pretendimin e saj për mosmarrjen dijeni për vendimin.

19.3 Për sa i përket pretendimit të ankueses se vendimi nr. 117, datë 17.9.2001, i KLD-së është absolutisht i pavlefshëm dhe mund të kundërshtohet në çdo kohë, KLGJ-ja prapëson se është i pabazuar, pasi i vetmi ligj që rregullonte marrëdhëniet e punës së ankueses në cilësinë e gjyqtarës, ishte ligji në fuqi, nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në këtë ligj kanë qenë të parashikuara rastet kur emërohej apo jepej masë disiplinore ndaj një gjyqtari, organin ku mund të bëhej ankimi, si dhe afati për ushtrimin e ankimit. Sipas nenit 46 të ligjit nr. 8436/1998 dhe nenit 34 të ligjit nr. 8811/2001, afati 10-ditor për ushtrimin e ankimit është afat prekluziv dhe nuk parashikohet rivendosje në afat e këtij ankimi, ndërprerje apo pezullim i afatit të ankimit dhe në këtë rast nuk zbatohen dispozitat e Kodit të

Procedurave Administrative, i cili është një ligj i karakterit të përgjithshëm.

19.4 Për sa u përket pretendimeve të ankueses për pavlefshmëri absolute të vendimit nr. 117, datë 17.9.2001, të KLD-së, konstatohet se ky vendim nuk përmban asnjë nga shkaqet e pavlefshmërisë absolute të parashikuara në nenin 116 të Kodit të Procedurave Administrative.

20. Në përfundim, KLGJ-ja vlerëson se është parashkruar e drejta e ankueses për të kundërshtuar vendimin nr. 117, datë 17.9.2001, të KLD-së, pasi kërkesa është paraqitur tej afateve të parashikuara në ligj dhe, për këtë arsye, Kolegji duhet të rrëzojë kërkesën e saj⁵.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Për legjitimitimin e ankueses

21. Juridiksioni dhe kompetenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në kuadër të Juridiksionit Disiplinor, janë parashikuar në nenin 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas së cilës *gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë*.

22. Çështja e legjitimitimit është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese, si një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2 e Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

⁵ Me shkresën nr. {**} prot., datë 27.7.2023, KLGJ-ja, bashkë me parashtimet ka dërguar bashkëlidhur aktet: i. kërkesë për verifikim nr. {**} prot., datë 20.8.2001, e zëvendësryetarit të KLD-së; ii. shkresë nr. {**} prot., datë 22.8.2001, e ministrit të drejtësisë; iii. Relacion i Inspektoratit të KLD-së për verifikimin e të dhënave për shkelje ligji për gjyqtaren Majlinda Mançellari, i datës 27.8.2001; iv. kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor nr. {**} Faqe | 2216

prot., datë 4.9.2001, e ministrit të drejtësisë; v. vendim nr. 117, datë 17.9.2001, i Këshillit të Lartë të Drejtësisë; vi. procesverbal i mbledhjes së KLD-së, i datës 17.9.2001; vii. shkresë nr. {**} prot., datë 26.9.2001, e ministrit të drejtësisë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe znj. Majlinda Mançellari, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.



23. Ankimi kushtetues individual duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

24. Në çështjen objekt shqyrtimi, lidhur me juridiksionin për gjykimin e kësaj çështjeje, Kolegji konstaton se vendimi objekt ankimi është dhënë nga KLD-ja, bazuar në nenin 147, pika 6 të Kushtetutës (para ndryshimeve me ligjin nr. 76/2016), nen i cili parashikonte se vendimet e KLD-së për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit ankimoheshin në Gjykatën e Lartë. Ky parashikim kushtetues ka qenë i reflektuar edhe në përmbajtjen e nenit 36 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 34 të ligjit nr. 8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, sipas të cilëve ndaj vendimit të shkarkimit nga detyra gjyqtari kishte të drejtë të ankohej në Gjykatën e Lartë, e cila vendoste në kolegje të bashkuara.

25. Pas ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, neni 140 i Kushtetutës, në pikën 4 ka përcaktuar se kundër vendimit të shkarkimit gjyqtari mund të bëjë ankim në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregullim kushtetues është reflektuar edhe në përmbajtjen e nenit 71, pika 3 e ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit Gjykata Kushtetuese shqyrton përfundimisht ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas nenit 140, pika 4 e Kushtetutës. Gjithashtu, konstatohet se pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, si dhe pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli të Lartë Gjyqësor i kanë kaluar kompetencat që më parë i kishte pasur Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dhe është organi që zëvendëson KLD-në⁶.

26. Bazuar në sa më sipër, Kolegji i Posaçëm i Apelit gjatë mandatit të tij është gjykata kompetente që ka në juridiksion edhe shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të KLD-së (KLGj-së) për

marrijen e masave disiplinore të shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve.

27. Lidhur me legjitimitimin e ankueses, Kolegji vlerëson se ankuesja legjitimohet *ratione personae*, pasi vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, është marrë në kuadrin e një procedimi disiplinor ndaj saj dhe ankuesja ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar, dhe se vullneti i ankueses në këtë rast duket se përcaktohet nga vendimi i Gjykatës së Lartë nr. {***} akti, datë 20.1.2023, i cili nuk i jep zgjidhje ankesës së saj, duke përcaktuar Kolegjin si gjykata që ka juridiksionin për shqyrtimin e kërkesës.

28. Për sa i përket verifikimit të kushteve të pikës 2/ç, të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, në harmoni me nenin 71/a, shkronja “b”, që kanë të bëjnë me afatin ligjor brenda të cilit duhet paraqitur ankimi kushtetues individual, nga të dhënat e akteve rezulton se vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka vendosur nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes me nr. {***}, datë regjistrimi 19.5.2016 dhe dërgimin e akteve për shqyrtim Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, është i datës 20.1.2023. Ankuesja pas marrjes dijeni për vendimin e mësipërm të Gjykatës së Lartë, më datë 27.3.2023, i është drejtuar me kërkesë Kolegjit duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 117, datë 17.9.2001, të KLD-së. Në këtë rast, në drejtim të legjitimitimit formal *ratione temporis* të ankueses, Kolegji ka vlerësuar që afati i paraqitjes së kërkesës në Kolegjin të llogaritet duke iu referuar vendimit të Gjykatës së Lartë që përcakton juridiksionin e Kolegjit. Për sa më sipër, në drejtim të afatit të paraqitjes së kërkesës, në zbatim të përcaktimit të pikës 2/ç, të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, rezulton se ankuesja legjitimohet *ratione temporis*, pasi ankimi plotëson kushtin e paraqitjes së tij brenda afatit 4-mujor.

29. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Kolegji çmon se pretendimet e ankueses ndaj vendimit nr. 117, datë 17.9.2001, të KLD-së janë pretendime që *prima facie* hyjnë në juridiksionin disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe do të shqyrtohen në vijim.

⁶ Neni 277 i ligjit nr. 115/2016 1: “Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë qëndrojnë në detyrë deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Mandati i anëtarëve përfundon në ditën kur zgjidhet anëtari i fundit i Këshillit të Lartë Gjyqësor, por në çdo rast jo më vonë se 8 muaj pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve Kushtetuese. [...] 4. Në

ditën e krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të gjitha dosjet dhe dokumentacioni në administrim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë i kalon Këshillit të Lartë Gjyqësor nën përgjegjësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Kryeinspektorit”.

**B. Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit**

30. Ankuesja e ka bazuar kërkesën e saj në pretendimin se vendimi nr. 117, datë 17.9.2001, është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm. Argumenti që sjell ankuesja në këtë drejtim është se vendimi objekt shqyrtimi është një akt administrativ individual absolutisht i pavlefshëm, i nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji, pasi është një akt të cilit i mungon arsyetimi, si një element i domosdoshëm për një proces të rregullt ligjor.

31. Në shqyrtim të pretendimeve të paraqitura nga ankuesja, Kolegji vëren se afati i ankimit ndaj vendimeve të KLD-së ka qenë i parashikuar në nenin 46 të ligjit nr. 8436/1998, në fuqi në kohën kur është dhënë vendimi objekt shqyrtimi. Sipas kësaj dispozite, gjyqtari, kur shkarkohet nga detyra për një nga arsytet e parashikuara në Kushtetutë, ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Afati 10-ditor për ushtrimin e ankimit ka qenë afat prekluziv dhe i detyrueshëm për zbatim për të kundërshtuar vendimet e KLD-së për çfarëdolloj shkaku. Parashikimi i nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative, i cituar nga ankuesja, i referohet të drejtës për paraqitjen e ankimit në organin administrativ epror dhe jo të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës, për të cilën ligji ka parashikuar një rregullim të posaçëm.

32. Ankuesja pretendon se nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 117, datë 17.9.2001, pasi nuk ka marrë njoftim lidhur me këtë vendim. Ankuesja pretendon se i është njoftuar vendimmarrja, por jo vendimi dhe se ky ka qenë shkaku që nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit. Sipas saj, nuk është realizuar njoftimi për sa kohë që nuk i është komunikuar një akt në kuptimin formal. Gjithashtu, ankuesja pretendon se njoftimi /komunikimi i vendimit nga ministri i drejtësisë nuk i është bërë në mënyrë individuale. Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, nga verifikimi i akteve që ka paraqitur KLGj-ja, Kolegji konstaton se ministri i drejtësisë, me të njëjtën shkresë me nr. {***} prot., datë 26.9.2001, i është drejtuar njëkohësisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe ankuses (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, *zgj.*

Majlinda Mançellari), duke njoftuar se: “Me vendimin nr. 117, datë 17.9.2001, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, *zgj.* Majlinda Mançellari, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, shkarkohet nga detyra e gjyqtarës”. Kjo shkresë është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec me nr. {***} prot., datë 28.9.2001. Në këtë shkresë vihet re dhe shënimi i drejtuesit të gjykatës, i datës 3.10.2001, drejtuar kancelarit të kësaj gjykate për kryerjen e veprimeve. Nga analizimi i saj, Kolegji konstaton se shkresa, që përmban edhe emrin e gjyqtarës Majlinda Mançellari, e protokolluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, është kaluar për veprim. Si rrjedhojë logjike, veprimet që kushtëzonte kjo shkresë ishin ato financiare për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, si dhe për detyrimin e gjyqtarës për kryerjen e dorëzimeve të dosjeve dhe dokumentacionit që kishte në ngarkim. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se shkresa me nr. {***} prot., datë 26.9.2001, e ministrit të drejtësisë, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec me nr. {***} prot., datë 28.9.2001, sjellë nga KLGj-ja së bashku me parashtrimet dhe përcjellë edhe ankuseses⁷, përbën një provë që njoftimi është kryer dhe ankuesja nuk e ka kundërshtuar me parashtrimet e saj. Pra, rezulton se ankuesja ka marrë dijeni për vendimmarrjen e KLD-së në muajin tetor 2001⁸, ashtu si dhe ka pranuar vetë në ankimin drejtuar Kolegjit. Referuar përmbajtjes së shkresës së mësipërme, si dhe ndërprerjes së marrëdhënieve të punës të ankuseses, Kolegji çmon se këto janë fakte të mjaftueshme për të konkluduar se ankuesja efektivisht ka pasur dijeni për vendimin e KLD-së për shkarkimin e saj nga detyra, dhe se janë të pabazuara pretendimet e saj se nuk ka marrë njoftim.

33. Për sa më sipër, Kolegji konstaton se ankuesja, megjithëse ka pasur dijeni për vendimmarrjen e KLD-së për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, nuk ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi brenda 10 ditësh, menjëherë sapo ka ndërprerë marrëdhëniet financiare me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Shkelja e afatit prekluziv 10-ditor të ankimit që parashikon neni 46 i ligjit të posaçëm nr.

⁷ Me shkrerat nr. {***} prot., datë 28.9.2023 dhe nr. {***} prot., datë 9.11.2023, të Kolegjit.

⁸ Në kërkesën që ankuesja i ka drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec në datën 22.4.2016 (që është pjesë e dosjes së Faqe| 2218

përcjellë në Kolegji nga Gjykata e Lartë), shprehet se ka punuar si gjyqtare pranë kësaj gjykate deri në shtator të vitit 2001.



8436/1998, ka sjellë si pasojë humbjen e të drejtës së ankueses për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë. Kolegji vëren se ankuesja, duke ngritur pretendimin se vendimi i KLD-së është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, kërkon që të bazojë dhe *të rivendosë në afat* kërkesën e saj, me arsyetimin se në rastin e një vendimi absolutisht të pavlefshëm, sipas nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative, kundërshtimi i vendimit mund të bëhet në çdo kohë.

34. Gjithashtu, Kolegji vëren se ankuesja nuk sjell asnjë provë për të provuar se menjëherë pas daljes së vendimit të KLD-së ajo të ketë bërë qoftë edhe një përpjekje të vetme për t'iu njohur dhe për të marrë një kopje të tij me qëllimin për ta kundërshtuar shkarkimin në Gjykatën e Lartë. Rezulton nga aktet se vetëm në datën 19.5.2016, pas gati 15 vitesh nga vendimmarrja e KLD-së, ankuesja ka depozituar në Gjykatën e Lartë kërkesën për pavlefshmëri absolute të vendimit nr. 117, datë 17.9.2001, të KLD-së. Kolegji konstaton se edhe në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatën e Lartë, sërish ankuesja nuk ka pasur kopje të vendimit të KLD-së, të cilin e ka marrë vetëm pas kërkesës së saj të datës 28.6.2016 (një muaj pasi kishte depozituar kërkesën në Gjykatën e Lartë, me shkresën kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 11.7.2016, të KLD-së). Këto dy akte, ankuesja edhe pse i ka marrë në vitin 2016, në mënyrë të pashpjegueshme i ka paraqitur në Gjykatën e Lartë në datën 7.10.2022, pas më shumë se 6 (gjashtë) vitesh nga regjistrimi i kërkesës në këtë gjykatë dhe nga disponimi i këtyre akteve.

35. Kolegji vëren se ankuesja nuk jep asnjë arsye objektive për të argumentuar dhe justifikuar faktin se përse vetëm pas gati 15 viteve, në datën 28.6.2016, i është drejtuar për herë të parë KLD-së me kërkesën për të marrë një kopje të vendimit nr. 117/2001 të këtij organi, si dhe përse edhe pas marrjes së këtij vendimi e ka depozituar atë në Gjykatën e Lartë me 6 (gjashtë) vite vonesë. Këto veprime/mosveprime të ankueses, si dhe sjellja e pashpjegueshme dhe e pakuptueshme e saj krijojnë bindjen e Kolegjit se ankuesja për vite të tëra nuk ka treguar asnjë interes për masën disiplinore të vendosur ndaj saj nga KLD-ja dhe demonstrojnë një qëndrim neglizhues dhe indiferent nga ana e saj për

të realizuar ushtrimin e të drejtës së ankimit dhe për të përmbushur kriteret formale që ligji i posaçëm nr. 8436/1998 parashikonte për ushtrimin e tij.

36. Kolegji çmon të theksojë se vërtet e drejta e ankimit, si e drejtë themelore e garantuar nga nenet 6 dhe 13 të Konventë Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në interpretim të parimeve juridike dhe frymës së legjislacionit procedural, është garanci për një proces të rregullt ligjor, por, nga ana tjetër, individit duke mos e ushtruar këtë të drejtë brenda afateve të përcaktuara ligjore, me vullnetin dhe me sjelljen e vet, në kushtet e mungesës së pengesave objektive, humbet mundësinë për të kërkuar realizimin e saj në çdo kohë dhe me çfarëdo mjeti ligjor apo procedural.

37. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka pohuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Megjithatë e drejta e aksesit mund të kufizohet, kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje. Gjykata ka pranuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën qëllim në vetvete, por është në funksion të parimit të sigurisë juridike, si një nga parimet themelore të shtetit të së drejtës. Mospërcaktimi i këtyre afateve do të çonte në një situatë të tillë, ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej apo prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë⁹.

38. Në përfundim të shqyrtimit të këtij ankimi, Kolegji vlerëson se ankuesja me vullnetin e saj nuk ka shfrytëzuar afatin ligjor të ankimit të parashikuar

⁹ Shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 9, datë 7.2.2017; nr. 18, datë 31.3.2014; dhe nr. 17, datë 19.6.2009, të Gjykatës Kushtetuese.



në ligjin e posaçëm e, për rrjedhojë, ka humbur të drejtën për të paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 117, datë 17.9.2001, të KLD-së.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Posaçëm i Apelit, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” e Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

- Mospranimin e ankimit të ankueses Majlinda Salillari (Mançellari) kundër vendimit nr. 117, datë 17.9.2001, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 15.12.2023.

Shpallur më 15.1.2024.

Kryetar: Sokol Çomo

Gjyqtarë: Mimoza Tasi, Albana Shtylla, Ina Rama, Natasha Mulaj, Rezarta Schuetz

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë